

LEKA BUNGO

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-2

1392


PABESIA
DRAMË

8JH-2
B 92

LEKA BUNGO

PABESIA

DRAMË



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktore
ISKRA THOMA

PERSONAZHET:

GJERGJI	— inxhinier
LJUBA	— gruaja e tij
PETRO	— babai, sekretar i organizatës së Partisë
KATINA	— e shoqja
AZEMI	— punëtor në brigadën e shpim- -kërkimit
DANIA	— » » »
KOZMAI	— » » »
VIKTORI	— inxhinier sovjetik
VASILI	— punëtor sovjetik
ALEKSEJ	— » »

Ngjarja zhvillohet në vitet '60-të, menjëherë
pas Konferencës së Moskës.

AKTI I PARE

Nata e Vtitit të Ri. Në apartamentin e saj, Ljuba pret e dëshpëruar të shoqin. Gramafoni shpërndan nëpër dhomë tingujt e një melodie të gëzuar.

Jashtë, në rrugë, dëgjohen zëra, urime, copëza këngësh. Duke pritur Ljuba është bërë nervoze, nervozizëm i cili lexohet hapur në veprimet e saj. Dëgjohet zilja e telefonit.

LJUBA — (Rrëmben receptorin.) Alo! Klubi sovjetik! Unë jam. Jo, ende nuk ka ardhur. Nuk është e mundur, ndryshe do të më kishte telefonuar. Gëzuar! Gëzuar! Janë mbledhur të gjithë... Si?... (Në portë dëgjohen trokitje.) Ja, ja, erdhi më në fund. Do të vijmë menjëherë. Dasfidanja! (Lë receptorin dhe nxiton për të hapur derën. Për një çast mbe-

tet e shtangur. Fare papritur, në derë shfaqet Viktori me një valixhe në dorë.) Ju... këtu!..., VIKTORI — S'më kishte shkuar asnjëherë ndër mend se pamja ime mund të të trondiste kaq shumë!...

LJUBA — (*Nuk e fsheh dot turbullimin.*) Më falni! T'ju them të drejtën, unë as që mund ta mendoja...

VIKTORI — ...se unë do të trokisja kaq papritur në portën e apartamentit tuaj, në Shqipëri, në këtë orë të vonë, natën e Vtit të Ri... Kështu?

LJUBA — Pikërisht kështu...

VIKTORI — Ju kërkoj ndjesë. Erdha sonte vetëm për të qenë korrekt me prindërit tuaj. Ata m'u lutën që dhuratat t'jua sillja para Vtit të Ri dhe, siç e shihni, e mbajta fjalën. (*Sheh orën.*) Viti i Ri vjen pas disa orësh... (*I zgjat valixhen.*) Merreni... Është për ju...

LJUBA — Ju faleminderit!...

VIKTORI — (*Pas një heshtjeje të shkurtër.*) Ju nuk më ftoni të ulem?

LJUBA — Ju lutem, mos ma vini re. Urdhëroni, urdhëroni brenda.

(*Viktori zë vend në kolltuk. Me bishtin e syrit ai ndjek vështrimin e trembur të Ljubës.*) Im shoq tanë duhet të vijë. Sonte jemi ftuar në klubin tonë për të kaluar natën e Vtit të Ri. Siç duket kanë pasur ndonjë avari në pus. Ditët e fundit nuk është kthyer fare në shtëpi. (*Zgjat paketën e cigareve.*) Ndizeni!

VIKTORI — Ju faleminderit! (*Hesht një çast.*) Prindërit ju dërgojnë shumë të fala. Të gjithë janë

mirë. Ju kanë shkruar edhe një letër. (*E nxjerr nga portofoli dhe ia jep.*) I kishte marrë malli shumë pér ty...

LJUBA — Kur keni ardhur në Shqipëri?

VIKTORI — Sot bëhet plot një javë. Qëndrova në Tiranë disa ditë...

LJUBA — Do të rrini shumë kohë?

VIKTORI — Të shohim. Tani pér tanj nuk mund t'ju them më tepër se sa «të shohim»!...

(*Hesht një çast. Ljuba vazhdimesht i shmanget vështrimit të tij.*)

Ja, pra, s'kanë kaluar akoma tre muaj, dhe ne u takuam përsëri, po kësaj radhe në apartamentin tuaj të ri... Ju ka marrë malli pér Moskën?

LJUBA — Edhe pér Moskën, edhe pér njerëzit. Më falni! (*Ngrihet dhe i servir pije.*) Urdhëroni!

VIKTORI — Ju faleminderit! Përpara se t'ju uroj Vitin e Ri më lejoni t'ju njoftoj një lajm të gëzueshëm. Disa ditë më parë, babai juaj u emërua instruktor në komitetin e partisë. Urime dhe gëzuar Vitin e Ri, Ljuba!

LJUBA — Gëzuar!

VIKTORI — Sidoqoftë, këtej e tutje do të kemi rast të shihemi shpesh bashkë. Unë jam emëruar me punë në Shqipëri. Këto ditë filloj punën në zonën e re. Pra, do të punoj së bashku me burrin tuaj...

LJUBA — (*Jo pa habi.*) Ju jeni emëruar në vend të Sergeit?

VIKTORI — Po: (*Pas një heshtjeje të shkurtër.*) Ljuba, tre muaj më parë, në Moskë, unë,

babai juaj dhe ti, kemi lënë përgjysmë një bisedë...

LJUBA — Po...

VIKTORI — Dhe nuk keni asgjë pér të më thënë?

LJUBA — Kam...

VIKTORI — (*Pas një heshtjeje të shkurtër.*) Unë po pres...

LJUBA — Është vështirë. Tepër vështirë. Në fillim unë mendoja se çdo gjë ishte e thjeshtë... Ai më dashuronte me dashurinë e ciltërsinë e një fëmije, dhe unë shpresoja se në oqeanin e kësaj dashurie do ta mbysja ëndrrën e tij... Por, siç duket, qen kam nxituar...

VIKTORI — Nxituar?!

LJUBA — Po. Kohët e fundit, në marrëdhëniet tonë, shumë gjëra kanë ndryshuar. Ai s'më ka folur kurrë por, unë jam grua dhe e ndiej. E ndiej, kur më sheh, kur më flet... e ndiej kur më përkëdhel... dhe kjo më tremb...

VIKTORI — Si duhet t'i kuptoj këto fjalë? Ju keni vendosur të ndaleni në mes të rrugës?

LJUBA — Nuk mundem. Besomëni. Nuk mundem më. Këto mure, kjo dhomë, kjo shtëpi, ky qytet... të gjitha më duken si një varr i madh dhe unë...

VIKTORI — (*Kërcënues.*) Ljuba... të gjitha këto janë fjalë... fjalë!... Dëshirat, qëllimet, ndryshojnë në jetën e njeriut. Tashmë asgjë nuk varet nga ti, nga unë... (*Ljuba ul kokën e menduar.*) Javët, ditët rrrokuillisen njëra pas tjetrës, ndërsa gjérat sa vijnë e vështirësohen më tepër. Shqiptarët...

LJUBA — Me sa duket ju nuk i njihni mirë shqip-

tarët. Mos harroni! Unë jetoj prej vitesh mëdis tyre... Ata janë të lidhur shumë pas njëri tjetrit, pas familjes, pas Partisë së tyre! (*Heshtje e shkurtër.*) Pandehni se ishte e lehtë për ta shkëputur tim shoq nga kthetrat e familjes, nga kthetrat e Petros, babait të tij?

VIKTORI — Nuk dysho...

LJUBA — Ju e dini, vjehrri im është sekretar partie. Veç kësaj ai është mjeshtër i zoti dhe plak tepër i mençur. Burri im e do dhe e respekton atë si të ishte perëndi. Ja, pra, cila ishte për mua pengesa e parë, të cilën duhej ta kapërceja me çdo kusht dhe pa u rrëzuar.

VIKTORI — Nuk ju kuptojoj. Atëherë përsë u larguat pa e kapërcyer?

LJUBA — Sepse ishte e pamundur. Nuk do të kalojnë shumë kohë dhe ju do të bindeni përfjalët e mia!...

VIKTORI — Kurse unë kam frikë, se pikërisht kjo e ka vështirësuar ende më shumë punën tënde...

LJUBA — Përkundrazi. Unë ngula këmbë që të ndaheshim nga familja e tij, sepse duke qenë i izoluar nga i ati, im shoq mund të thyhej më lehtë. Atij as që i shkon ndër mend qëllimi im i vërtetë. Ai pandeh se kjo ndarje ishte një kërkësë e natyrshme e kohës... (*Heshti një çast. I zgjat shkrepësen.*) Ndizeni!

VIKTORI — E, megjithatë, të gjitha këto mbeten fjalë, Ljuba, fjalë!... Shqiptarët me çdo kusht duhet të tërhiqen nga zona. Më kuptioni? Me çdo kusht e sa më parë. Ata duhet të bin-

den se tërë përpjekjet për të zbuluar naftë në tokën e tyre janë pa shpresë. Ata duhet të binden njëherë e përgjithmonë se toka e tyre është shterpë. Shterpë! Vetëm atëherë shqiptarët do të bien në gjunjë përpara këmbëve tonë dhe që të na shtrinë dorën për bukë. (*Heshtje e shkurtër.*) Ja cila është arsyeja e emërimit tim në Shqipëri... (*Në korridor dëgjohet zhurmë.*) Dikush po vjen... (*Ljuba del në korridor.*)

LJUBA (*Pas pak.*) Jo, nuk ka njeri...

VIKTORI — Në ambasadë më njoftohën me gjendjen në zonë. Të gjithë janë të mendimit se e vetmja nyje, që e zgjidh këtë lëmsh, është Gjergji, burri juaj...

LJUBA — (*E menduar.*) Gjergji?!

VIKTORI — Ljuba, tërheqja e Gjergjit është gjithçka për ne... Në pus ka disa ditë që janë ndërprerë punimet. Shpimi më tej nuk mund të vazhdojë, sepse shqiptarët nuk kanë mjetë teknike. I vetmi burim është Moska.

LJUBA — (*Ndez shkrepësen.*) Ndizeni! (*Përsëri iu shua...*)

VIKTORI — Të gjitha shpresat shqiptarët i kanë varur në analizat e kampionëve të fundit, që u nisen në laboratorin e Moskës. Në fillim ata nuk deshën që analizat të bëhen në Moskë. Por këmbëngulja e specialistëve tanë i mposhti. (*Heshti një çast.*) Pas disa ditësh grupei sovjetik do të heqë dorë njëherë e përgjithmonë nga kjo «aventurë»... E kuptioni më në fund? E vetmja barrikadë mbetet Gjergji.

Ja, pra, pse têrheqja e tij është gjithçka pér ne...

LJUBA — Nuk e di, ndoshta gabohem. Ai është njeri tepër i ndershëm. Ju nuk mund ta merrni me mend pasionin e tij pér punën, pér shkencën; bindjen e tij të verbër. Ditët e fundit unë provova...

VIKTORI — Ljuba, ti je grua e mençur. Koha nuk prenton pér prova... Gjergji duhet të heqë dorë nga puna dhe ajo që duhet ta bëjë këtë je ti. Ti dhe askush tjetër.

LJUBA — Si? Në ç'ményrë?

VIKTORI — Në fund të fundit edhe duke e frikësuar...

LJUBA — Çfarë?

VIKTORI — Ju duhet ta trembni atë. Frika ka ulur në gjunjë njerëz më të guximshëm se burri juaj. Ai nuk duhet të harrojë se dështimi i punimeve në zonën e dytë mund të jetë fundi i karrierës së tij. (*Heshtje.*) Përse mendoheni?

LJUBA — Për të gjitha këto...

VIKTORI — Unë kam besim tek ti, Ljuba...

LJUBA — Të shohim...

VIKTORI — (*Duke parë orën.*) Vajti tepër vonë. Rruga ishte tërë pluhur, prandaj duhet të bëj banjë... (*Ngrihet.*)

LJUBA — Ju do të vini në mbrëmjen tonë?

VIKTORI — Patjetër. Viti i Ri nuk kalohet vetëm. Aq më shumë në një vend të huaj...

LJUBA — Atëherë, pas pak do të takohemi përsëri. atje do të kini rast të njiheni edhe me burrin tim.

VIKTORI — (*Tek porta.*) Besoj, nuk është nevoja t'ju kujtoj që duhet të jeni shumë e kujdes-shme. (*Buzëqesh.*) Siberia nuk është larg as për prindërit e tu në Moskë dhe as për ne. Dasfidanja!

(*Viktori del.*)

LJUBA — (*Më tepër vetes.*) Dasfidanja!

(*Pasi mbyll portën, Ljuba afrohet pranë dritares dhe ndjek për një kohë të gjatë Viktorin, që largohet jashtë në rrugë. E menduar kthehet ngadalë dhe ulet në kolltuk. Gris zarfin dhe lexon letrën me zë të mbytur.) «Fjalët e Viktorit janë edhe të miat. Pra, tani e tutje nuk do të jesh më vetëm. Për çdo gjë Viktorin e ke pranë. Të përqafojmë me mall...»*

(*Hap valixhen dhe nxjerr dhuratat nga Moska: pardësy dhe triko për Gjergjin, orë tavoline, peizazhe me pamje nga Moska, një seri me pllaka gramafoni, këpucë etj. I vështron një çast. Jashtë në korridor dëgjohet zhurmë. Ajo shtrihet me nxitim në divan. Hyn Gjergji. Rrobat e punës i janë spërkatur gjithandej me baltë. Duket tepër i lодhur.*)

GJERGJI — Ljuba... Të paska zënë gjumi... (*I afrohet dhe e puth. Pastaj zhvishet pa zhurmë.*)

LJUBA — Gjergji, ti je?

GJERGJI — Unë...

LJUBA — Nuk të ndjeva fare...

GJERGJI — Ke shumë që fle?

LJUBA — Nuk mbaj mend kur më zuri gjumi. Sa
është ora?

GJERGJI — Dhjetë.

LJUBA — (*Me ironi.*) Mendova se nuk do të vije
fare sonte...

GJERGJI — (*Qesh.*) Kaq shumë je zemëruar me
mua? E si mund të të lija vetëm sonte?

LJUBA — Dikur, kur ishim studentë në Moskë, ti
nuk mund të ndaheshe asnjë çast prej meje.
Ne dilnim, shëtisnim, qeshnim, vallëzonim
bashkë. Kurse tani... tani shumë gjëra kanë
ndryshuar...

GJERGJI — Ljuba...

LJUBA — Unë lashë Moskën, njerëzit, braktisa
prindërit për hir të Gjergjit, ndërsa...

GJERGJI — Ljuba, budallaçka ime... ke të drejtë
që zemërohesh me mua! (*Hesht një çast.*)
Kohët e fundit punët në zonë nuk na venë
hiç mirë. Shpimi është ndërprerë. Shokët
sovjetikë ngulin këmbë të mos vazhdojnë
shpimin më tej pa kolonë teknike. Ndërsa ko-
lonë teknike s'kemi. S'kemi, Ljuba! Vapori
duhet të kishte ardhur tre muaj më parë
nga Odesa, ndërsa ne presim. (*Hesht një çast.*)
Njerëzit më shohin në sy. Vështrimi i tyre
s'më shqitet për asnjë çast: në pus, në baran-
gë, në mensë, në shtrat. Sytë e tyre më ndje-
kin pas: «Gjergj, inxhinier, q'do bëjmë, inxhi-
nier?»... Ndërsa unë hesht! (*Heshtje e shkur-
tër.*) Ljuba, a e di q'do të thotë që shpimi
të mos vazhdohet më tej? Nga çasti në çast
trungu i pusit mund të shëmbet dhe...

LJUBA — E bashkë me të mund të shëmbet edhe

ëndrra e Gjergjit? Ëndrra e tij për zbulimin e zonave të reja! Etja e tij për t'u bërë i famshëm edhe jashtë kufijve të Shqipërisë!...
GJERGJI — (*I indinjuar përpinqet që ta ndërpresë.*)
Ljuba!...

LJUBA — (*Me zë të lartë.*) Eja në vete, Gjergj! E tërë kjo histori është një aventurë e rrëzikshme, një aventurë e cila mund të paguhet shtrenjtë! (*Heshtje.*) Gjergj, ti je i mençur. Specialistët tanë po tërhiqen njëri pas tjetrit dhe, mos harro, ata janë përleshur me naftën në Baku, në Siberi... kurse ti...

GJERGJI — Ljuba, nuk më paske njohur mirë. Unë nuk jam frikacak! Unë atje e shoh, unë atje e ndiej naftën...

LJUBA — (*Shpërthen me zë më të lartë.*) Ëndrra! Ëndrrat e një egoisti të çmendur që, kur të zgjohet, nuk do të arrijë të pendohet! (*Heshtje e shkurtër.*) Kurrë, kurrë s'kam pandehur se një ditë njerëzit do të më quajnë Dulqinja e Tobozës...

GJERGJI — (*I fyer.*) Çfarë? (*Ljuba bie në divan e qan me dënesë. Heshtje. Gjergji afrohet pranë saj.*) Ljuba!

LJUBA — (*Kthehet me rrëmbim.*) Gjergj, unë kam frikë, kam frikë për ty, Gjergj! Për veten time! Kam frikë për dashurinë tonë!..

GJERGJI — Frikë?

LJUBA — Po, frikë. Një vit më parë unë besoja plotësisht në suksesin tënd. Projekti yt për zbulimin e zonave të reja bëri bujë deri në qarget shkencore të Moskës. Të gjithë të shihnin me zili, të gjithë. Një vit të tërë

ëndrra, shpresa, miliona lekë; një vit të tërë mund, djersë, pagjumësi, sakrifica, dhe pastaj fundi erdhi i pamëshirshiën. Zona ishte shterpë, shterpë. Megjithatë ti nuk hoqe dorë! Përsëri, sipas projektit tënd, punimet filuan në zonën e dytë. Dhe përsëri dështimi po të troket në derë. (*Hesht një çast.*) Përse më sheh ashtu?

GJERGJI — Ljuba! Unë nuk jam frikacak! Unë atje e shoh, unë atje e ndiej naftën... (*Bie zilja e telefonit.*)

LJUBA — Alo, unë jam. Erdhi, Po, po, do të vijmë pas pak. (*Ul receptorin dhe vështron Gjergjin për një kohë të gjatë në sy.*) Gjergj marrëzitë shpesh janë pjellë e mërzisë. Ditët e fundit e kam ndier veten tepër të vëtmuar, benda këtyre mureve... (*Heshtje. Ljuba i afrohet pranë dhe i flet me ton përkëdhelës.*) Sonte është nata e Vtitit të Ri. Në netë të tilla njërezit i hedhin tej marrëzitë, në vitin tjetër... Gjergji, shokët na presin në mbrëmje. Ty të flas! (*Gjergji ngrihet i heshtur. Ljuba nxiton dhe i afron valixhen me dhuratat e Moskës.*) Të pëlqejnë?

GJERGJI — Shkojmë. Më parë do të bëjmë një vizitë tek pleqtë...

LJUBA — (*Nuk e ka dëgjuar.*) Edhe një sekondë... (*Merr një pllakë të re gramafoni nga valixhja dhe pasi e vendos në gramafon hap çelësin. Tingujt e valsit përhapen në dhomë.*) Të kujtohet? (*Gjergji i shmanget vështrimit të saj.*) Atë mbrëmje nuk do ta harroj kurrë. Salla ishte e mbushur plot e përplot me njerëz. Ti

ishe ulur pranë kolonës së mermertë dhe vështroje vjedhurazi nga unë. Tingujt e valsit u përhapën në sallë dhe ti i ndruajtur u afrove pranë meje. Ne nisëm të kërcenim. (Në derën e jashtme dëgjohen trokitje. Pastaj një zë: «A pret miq, o i zoti i shtëpisë?».)

LJUBA — Ç'është kjo vizitë e papritur?

GJERGJI — Babai!...

LJUBA — Edhe ai... (Gjergji pasi i hedh një vështrim të rreptë Ljubës, hap derën.)

GJERGJI — Mirëse erdhe, baba! Vetëm qenke?

PETROJA — Plakut s'i ndahet shpirti kollaj nga plaka... (Përqafohen. Pas tij hyn Katina. Ajo mban në duar një tepsi të mbuluar.) Gëzuar, gëzuar Vitin e Ri, bir i babait!

GJERGJI — Gëzuar dhe mirëse na erdhët!

KATINA — Bir i nënës, gëzuar të keqen! Gëzuar, moj nuse!

LJUBA — Gëzuar!

GJERGJI — Zini vend. Ulu, nënë. Përse rri në këmbë? (Ata zënë vend. I zgjat paketën e duhanit të atit.) Ndize!...

PETROJA — (Nxjerr çibukun.) S'bëjnë përmua ato!...

KATINA — Zemra ma thoshte se do të vinit andej nga ne, sonte; qysh javën e parë i thashë Petros, por këtij i është bërë mendja naftë... (Hesht një çast.) Sonte m'u mblodhën të gjithë. Edhe Sandri na erdhi. Vetëm ju munigonit.

GJERGJI — Sandri? Përse nuk e morët me vete?

PETROJA — Aha, s'vi unë, tha. Po të dojë le të vijë Gjergji tek ne.

KATINA — Ashtu tha, ashtu tha... qerosi!

PETROJA — Gjergji vërtet është më i madh nga unë në moshë, tha, por me pozitë ia marr. Se, që ta dish ti, Sandrin e kanë graduuar, e kanë bërë tetar! (Qeshin.)

KATINA — Si më i hequr më dukesh kësaj radhe, bir!

GJERGJI — Ashtu të duket, nënë. Me shëndet jam shumë mirë.

PETROJA — Mos u bëj merak, se nuk i gjen gjë të rinjtë... Këta u rritën dhe jetën e kanë përpara... (Me të qeshur.) Kujdesu për plakun...

KATINA — Ty as që ta kam merakun fare. Je më suar në punë tërë jetën ti! Po djali më është hequr fare se edhe punën s'e ka të lehtë...

PETROJA — (Me shaka.) E, e, të ka faj plaka...

GJERGJI — Nënë, si ke qenë këto ditë?

KATINA — Po ja, mor bir, ashtu. Kjo e flamosur reumatizëm më shtrëngon sa herë që ngryset moti.

PETROJA — (E ngacmon.) Hë, moj e uruar, se tërë jetën më shumë i ke rënë ti në qafë sëmundjes se sa ajo ty...


(Katina për herë të parë vë re Ljubën që rri në këmbë.)

KATINA — Nuse, po ti pse rri në këmbë? Ulu, të keqen nëna...

LJUBA — Ne, ne jemi bërë gati të shkojmë në mbrëmje... (Gjergji ngrihet me rrëmbim i bërë flakë në fytyrë.)

GJERGJI — Ljuba! (Heshtje e gjatë.)

LJUBA — Unë nuk thashë...



GJERGJI — Shtrona tavolinën...

LJUBA — (*E habitur.*) Si?

PETROJA — (*I prekur.*) Ne... nuk kemi ardhur për të ndenjur...

GJERGJI — Ljuba! (*Thërret me forcë.*) Dëgjove?

LJUBA — (*Mezi e mban zemërimin.*) Da!

(*Largo het me rrëmbim në dhomën tjetër. Heshtje e nderë.*)

KATINA — Nuk bëre mirë, djalë i nënës!

PETROJA — Nuk kemi ardhur për të ndenjur. Erdhëm t'ju urojmë Vitin e Ri dhe përsëri do të shkojmë. Edhe në shtëpi na presin...

GJERGJI — Baba... mos ia vër re. Ti e njeh. Nganjëherë Ljuba bën si fëmijë...

PETROJA — Megjithëse nuk është e vogël...

GJERGJI — Baba, për hatrin tim. Mos ma prish sonte. Nuk mund ta merrni me mend se sa mirë bëtë që erdhët. (*Hesht një çast.*) Sonte kisha shumë nevojë për njerëz! (*Hesht.*) Sidomos për ty, baba!

KATINA — (*Petros.*) Edhe ti, zemrën gur e ke!

GJERGJI — Ti ike dje papritur në Qytetin Stalin dhe bashkë nuk u takuam. Sot përsëri të prita...

PETROJA — U vonuam. Në komitetin e partisë mbledhja vazhdoi deri në mbrëmje vonë...

GJERGJI — Dania u kthye nga Durrësi. Edhe kësaj radhe asnje vapor nuk u shkarkua për ne...

PETROJA — (*I menduar.*) E di... Edhe kësaj rade...

GJERGJI — Nuk më the çfarë u vendos në mble-dhje?

PETROJA — Asgjë. Të gjithë ishin të mendimit se pa ardhur përgjigjja e analizave nga Moska nuk mund të merret asnje vendim. Bile, shokët sovjetikë ngulin këmbë se, në qoftë se edhe kësaj radhe kampionët nuk flasin hapur, punimet duhet të ndërpriten.

GJERGJI — (*I habitur.*) Të ndërpriten?

PETROJA — Po. Të ndërpriten. Edhe sonda të transportohet në zonën e tretë! (*I menduar.*) Të shohim. Kam një jetë të tërë që përfytem me naftën, por si kohët e fundit...

GJERGJI — Baba... edhe ti ke nisur të humbasësh besimin?

PETROJA — Jo, djalë, përkundrazi. Kohët e fundit po bindem gjithnjë e më shumë se nën këmbët tonë nafta hidhet e përdridhet me tallje, ndërsa ne nuk jemi në gjendje ta mbërthejmë për gryke e ta nxjerrim jashtë... (*Hyn Ljuba.*)

LJUBA — Tavolina është gati...

PETROJA — (*Rëndë.*) Shkojmë, grua!

GJERGJI — Baba!

PETROJA — Thashë, nuk kemi ardhur për të ndejnur...

GJERGJI — Aq sa të rrini, qoftë edhe pesë minuta. Ne kemi kohë për të shkuar në mbrëmje, apo jo, Ljuba? Nata e Vtit të Ri është e gjatë. (*Me të qeshur.*) Është e vetmja natë që zgjat një vit të tërë... (*Në derë dëgjohen trokitje.*)

KATINA — Porta, nuse!

(*Ljuba hap derën. Hyn Vasili.*)

PETROJA — Kuqoja?!

GJERGJI — (*Thérret i kënaqur.*) Vasja!?

VASILI — (*I habitur.*) Ooo, miqtë e mi të vjetër.
Gëzuar Vitin e Ri, miqtë e mi të mirë!...

GJERGJI — Gëzuar e mirëse erdhe, i dashur Vasja!
Urdhéro brenda...

VASILI — (*I zgjat dorën Ljubës.*) Mirëmbrëma dhe
gëzuar, shoqja Ljuba!

LJUBA — Faleminderit!

VASILI — Siç duket nuk më mban mend. E pra,
tre muaj më parë, ju së bashku me nxënësit
tuaj të vegjël erdhët në pusin tonë dhe unë
ju mbajta një fjalim të gjatë...

LJUBA — T'ju them të drejtën...

VASILI — S'ju kujtohem? (*Qesh.*) Në fund të fundit
për njerëzit nuk është ndonjë humbje e ma-
dhe të mos njohin Vasilin, ose në gjuhën jo-
zyrtare, Kuqon!

KATIMA — Paska pirë, i ziu!...

GJERGJI — (*Duke qeshar.*) Ulu, Vasja.

VASILI — Ju faleminderit me gjithë shpirt, por
nuk kam ardhur për t'u shtruar. Sonte kam
ardhur për të plotësuar një marrëzi, që më
shkrepit papritur në kokë! Dua të takohem
me të gjithë shqiptarët e zonës. Të njohur
edhe të panjohur e t'u uroj nga zemra që
Vitin e Ri 1961 ta kalojnë gëzuar! (*Heshtje.*)
Deri në mëngjes dua t'i uroj të gjithë shqip-
tarët. Të gjithë.

KATIMA — Të lumshin këmbët, or mik!

VASILI — (*I afrohet Katinës.*) Nëna, inxhinier?

GJERGJI — Po.

VASILI — Unë punoj bashkë me djalin tuaj. Bash-

kë me burrin tuaj. Ata më njohin mirë. Nënë, unë nuk jam pianec. Mos më shih ash-
tu. Kuqoja s'ka pirë kurrë në jetën e tij. Nuk
besoni në fjalët e mia?

GJERGJI — Përse të mos besojmë, Vasja?

VASILI — Inxhinier, ti je i mençur, por Vasja është
më i vjetër. Mosbesimin e lexon në sytë e
tjetrit dhe kur nuk je i shkolluar. Apo jo,
usta Petro? (*Heshtje. Ata shikohen sy më sy.*)

GJERGJI — Vasja, sonte është nata e Vitit të Ri
dhe të gjithë njerëzit pinë...

VASILI — Po, inxhinier, sonte të gjithë njerëzit pi-
në. Pinë; dehen dhe kur ngrihen në mëngjes
tallen me veten e tyre. Por ka edhe njerëz
të cilët pinë aq shumë, aq shumë... sa mbe-
ten të dehur për vite me radhë. Ata nisin të
harrojnë, nisin të mësohen me veten e tyre,
sepse kujtojnë se kanë lindur të dehur.
(*Hesht një çast.*) Le të ngremë një dolli për
shqiptarët! Për ju! Gëzuar!...

GJERGJI — Gëzuar!...

LJUBA — (Nën zë.) Fjalët e tij nuk mbajnë erë
alkool!

VASILI — (Ljubës.) Sí, sí?

LJUBA — Thashë: sa të pështirë i bën njerëzit pija!

VASILI — Çfarë? (Qesh.) Të pështirë? Të pështirë
nga pija? Ljuba, a ju ka rastisur të shihni
ndonjëherë njerëz të dehur, që s'kanë pirë
kurrë në jetën e tyre?

LJUBA — (Qesh me sforco.) Të dehur që s'kanë pi-
rë kurrë?

VASILI — Ndërsa unë kam parë, e dashur Ljuba!

Kam parë. Kam parë dhe ata nuk janë pak.
Ata nuk janë vetëm të pështirë...

GJERGJI — Vasja... në fillim pandeha se vetëm kishe pirë. (*I afrohet.*) Ulu! Ti seç ke sonte!

VASILI — Sonte? Jo, Gjergji. Kohët e fundit unë kam pirë çdo ditë...

GJERGJI — Kuqo!...

VASILI — Asgjë, inxhinier. Asgjë nuk kam. Përkundrazi, këtu ndërmjet jush e ndiej veten shumë mirë. (*Heshtje e shkurtër.*) Usta Petro, jeni i vetmi njeri ju që s'ma shtrënguat dorën sonte...

PETROJA — (*Buzëqesh.*) Njëherë po...

VASILI — Jo, usta Petro. Vërtet ne u takuam bashkë dhe ti më dhe dorën, por nuk ma shtrëngove, nuk ma shtrëngove sipas zakonit tënd. Unë nuk jam i dehur. Dhe tani, ju lutem, të më falni. Vajti vonë, dhe unë dua që marrëzinë time ta shpie deri në fund.

LJUBA — Nuk do të bënët keq të kthehet në shtëpi...

VASILI — (*Qesh hidhur.*) Shtëpia ime është larg, Ljuba, shumë larg prej këtej... Pak më parë isha në klubin tonë. Atje të gjitha familjet sovjetike janë mbledhur dhe pinë, këndoijnë, kërcejnë, ndërsa unë... ndërmjet gjithë atyre njerëzve e ndieja veten të vetmuar... Fare të vetmuar!...

GJERGJI — I vetmuar ndërmjet njerëzve? Vasja, rri sonte me ne...

VASILI — Jo, inxhinier, megjithëse ty të dua shumë. Shumë. (*Niset ngadalë, po qëndron përsëri tek porta.*) Usta Petro!.. Natën e mirë! (*Hesh-*

tje.) Unë nuk jam i dehur. (*I afrohet Ljubës.*) Duaje Gjergjin me gjithë shpirt, Ljuba! Ai është inxhinier i zoti, djalë i ndershëm. Duaje, Ljuba!

LJUBA — Në jetën time s'kisha ndenjur kurrë kaq pranë me një të dehur...

VASILI — Në fund të fundit njeriu nuk duhet të trembet nga një i dehur, Ljuba! (*Vështron në drejtim të Petros.*) Unë njoh njerëz që s'tremben as nga shtatë të dehur. Po, po, shtatë. Dhe i shtati, kur dehet, është më i frikshëm... Ljuba! Atij i merren këmbët dhe, nga çasti në çast, duket sikur do të bjerë... Po se ku? As ai vetë nuk e di... (*Del. Në dhomë heshtje e gjatë. E nderë.*)

PETROJA — (*Me vete.*) Nuk je i dehur Vasja, e shoh! E di!.. Ti nuk je i dehur...

LJUBA — Marrëzira të tilla vetëm një i dehur mund t'i thotë... (*Heshtje. Ljuba largohet në dhomën tjetër.*)

GJERGJI — (*Vetes.*) Ato fjalë nuk mbajnë erë marrëzi. Atë njeri s'e kam parë kurrë kaq të tronditür! (*Petros.*) Vërtet, baba, më parë Vasja s'pinte kurrë, ndërsa kohët e fundit...

PETROJA — Ka raste, bir, kur njeriu preket rëndë në jetë... Rëndë... Thellë në shpirt. Dhe kjo ndodh kur ai zhgënjehet në gjëra të mëdha... (*Dëgjohet zilja e telefonit. Ljuba hyn me nxitim e merr telefonin.*)

LJUBA — Alo!... Ljuba... Si? Prisni pak. Gjergji, të kërkojnë...

GJERGJI — Cili është?

LJUBA — Aleksej. Telefonon nga klubi...

GJERGJI — Çfarë kërkon Aleksej? I thuaj...

LJUBA — (Nuk e përmban dot zemërimin.) Çfarë kërkon? Gjergj, ata na presin. Ti vetë u ke dhënë fjalën. Të gjithë janë mbledhur ndërsa ne... (Përplas receptorin me forcë pas telefonit dhe vrapon në dhomën tjetër.)

GJERGJI — (Thérret.) Ljuba! (Heshtje.)

PETROJA — Shkojmë...

GJERGJI — Baba...

PETROJA — Bir... dikur, vite më parë, të kam thënë ca fjalë... Atëherë ti i mbajte mëri babait! (Tregon Katinën.) Edhe kësaj. Po atëherë ti ishe i ri, dhe unë... Katina, shkojmë... (Del.)

KATINA — Natën e mirë, të keqen nëna! Atje mbi komodinë të kam lënë një tepsi të vogël me revani. E bëra për ty, se e di që të pëlqen shumë. Natën e mirë, të keqen!... (Del.) (Gjergji i tronditur kthehet dhe ulet nga dalë në kolktuk. Sytë i shkojnë tek çibuku i Petros mbi tavolinë.)

GJERGJI — E harroi!... Pra, shokët sovjetikë ngulin këmbë, se në qoftë se edhe kësaj radhe kampionët nuk flasin hapur, punimet duhet të ndërpriten! (Hesht një çast. I vijnë ndër mend fjalët e Ljubës: «Unë lashë Moskën, braktisa prindërit e mi për hir të dashurisë... Gjergj, kjo është një aventurë e rrezikshme që do të kushtojë shtrenjtë...») Eh, sa më dhemb koka! (Ngrihet për të hapur dritharen por ndalet sepse e sheh të hapur. Dëgjo-

hen trokitje në portë. Gjergji afrohet nga-dalë dhe hap portën.) Cilin kërkon?

VIKTORI — (Viktori hyn, është veshur me kostumin e mbrëmjes.) Juve, inxhinier Gjergji!

GJERGJI — Mua?

VIKTORI — (Duke buzëqeshur.) Ju keni të drejtë të habiteni, nuk më njihni... Ndërsa unë ju njoh fare mirë. Emri juaj ka ardhur prej kohësh në Moskë. Më lejoni të njihemi. (I zgjat dorën.) Viktor Zamuhin, kolegu juaj i ardhshëm...

GJERGJI — (Pak i habitur.) Ah po, më falni... Ju lutem, urdhëroni...

VIKTORI — Ju faleminderit! Në shtëpinë tuaj isha pak më parë. Tani erdha t'ju marr. Në klub janë mbledhur të gjithë, vetëm juve ju presin. Siç duket ju duan, ju respektojnë. Përse ta fsheh, edhe unë isha kurioz dhe më në fund... ja tek u njohëm... Zotësinë, optimizmin dhe kurajon tuaj e kam ndjekur nga larg. (Heshtje e shkurtër.) Shpresoj se së bashku do të merremi vesh për gjithçka...

GJERGJI — Ju e njihni nga afër projektin tonë për zonën e dytë?

VIKTORI — Deri në hollësi! (Ndërkohë Ljuba ka hyrë në dhomë, pa u vënë re dhe ndjek bisidën.)

GJERGJI — Dhe, ç'mendim keni?

VIKTORI — Nuk ju bëj kompliment, po t'ju them se projektin tuaj do ta kishte zili edhe një inxhinier, i cili ka pasur suksese gjatë gjithë karrierës së tij...

GJERGJI — (*Gjergji, nuk e fsheh dot kënaqësinë.*)
Natyrisht, ju...

VIKTORI — T'ju them të drejtën, në vështrim të parë, projekti më krijoj përshtypjen se kisha të bëja me një inxhinier aventurier, por kur e njoha në thellësi, u binda se fjalët e mira që kanë arritur për ju deri në rrethet shkençore të Moskës, nuk ishin pa bazë...

GJERGJI — Pra, ju jeni i bindur se kësaj radhe është qëlluar në shenjë?

VIKTORI — Plotësisht...

GJERGJI — Përse ta fsheh, edhe unë...

VIKTORI — Mësova se në laboratorin qëndror të Moskës janë shpënë për analiza kampione të marrë në 2800 metra thellësi!

GJERGJI — Pikërisht...

VIKTORI — Atëherë le të shpresojmë. Të presim dhe të shpresojmë... Në kohën tonë laboratori është gjithçka. (*Heshtje.*)

LJUBA — Pra, ju thoni se, në qoftë se analizat e kampionëve dalin pa shpresë...

VIKTORI — (*Për herë të parë e vë re Ljubën në dhomë.*) Oj, Ljuba! Të zhytur në misteret e naftës, as unë as Gjergji nuk të vumë re. Mirëmbërëma!

LJUBA — (*I jep dorën.*) Mirëmbërëma! Nuk më dhatë përgjigje, shoku Viktor...

VIKTORI — (*Duke qeshur.*) Gjergj, të paskam zili. Kujdesi i gruas për planet e bashkëshortit është vërtet një frymëzim i madh. Me keqardhje mund të pohoj se gruaja ime është e

kundërta e Ljubës. Ajo është e dhënë me mish e me shpirt pas muzikës...

LJUBA — Unë po pres, inxhinier...

VIKTORI — (Qesh.) Dhe unë po përpiqem t'ia shpje-
goj, Gjergj! (*Mendohet një çast.*) Në qoftë
se analizat e kampioneve nuk do të jatin
asnje shpresë, atëherë burri juaj do të jetë
si ai gjahtari që kthehet nga gjuetia i lodhur
dhe me trastë bosh...

LJUBA — Dhe më tej?

VIKTORI — Hej, dreq! Më tej? Të nesërmen, pa
zbardhur drita, do të niset përsëri për gjah,
në një pyll tjetër dhe kur të kthehet në
shtëpi, torbat nuk do t'i mjaftojnë për të
mbajtur gjahun... (*Qeshin.*)

LJUBA — Gjergj, ja që nafta nuk e ndryshka fan-
tazinë e një inxhinieri edhe në fushën e le-
tersisë. (*Dëgjohen trokitje.*)

VIKTORI — Dikush trokiti... (*Gjergji hap portën.
Hyn Azemi.*)

AZEMI — Mos jeni shurdhuar, ju këtej? Kemi një
orë që i biem borisë poshtë dritares suaj.

GJERGJI — Ç'ka ndodhur?

AZEMI — Avari, Gjergj. Manovra u ndërpre dhe
trungu i pusit u shëmb!...

GJERGJI — Si? Kush dha urdhër të ndërpritet ma-
novra?

AZEMI — Nuk e di. Unë nuk e di se kush dha një
urdhër të tillë!

GJERGJI — Ta hajë dreqi, ta hajë! (*Viktorit.*) Më
falni, më duhet të shkoj...

VIKTORI — Prit, Gjergj. Në pus do të vi edhe unë
me ty...

GJERGJI — Ju?

VIKTORI — Po! Në djall le të vejë dhe nata e Vtit
të Ri! (Del.)

LJUBA — (I del përpara Gjergjit.) Gjergj, mos më
ik i zemëruar... Unë do të të pres në dritare...

GJERGJI — Vërtet nuk mërzitesh?

LJUBA — Jo, Gjergj, përderisa ty të jep kënaqësi...

AKTI I DYTE

Një barangë prej dërrase e ndërtuar për punëtorët e shpim-kërkimit diku në afërsi të kullës së pusit.

Mëngjes dimri. Drita akoma nuk ka zbardhur mirë. Gjergji është ulur pranë tavolinës në korridor dhe diç punon në projekt. Kërkon të ndezë cigaren po shkrepësja i është mbaruar. Ngrihet dhe në majë të gishtërinjve hyn në dhomën ku flenë shokët. Kontrollon xhaketën e Kozmait.

KOZMAI — E kam nën jastëk...

GJERGJI — Akoma s'paske fjetur?

KOZMAI — Jo, nuk më zë gjumi. (I jep shkrepësen.)

Merre!

DANIA — (I shtrirë në krevat.) Sa vajti ora?

GJERGJI — Fli, Dane, është shpejt...

AZEMI — (*Ngrihet përgjysmë në shtrat.*) Natë më të shqetësuar se s'kam kaluar asnjëherë në jetën time. S'paska të mbaruar kurrë!

GJERGJI — Edhe ti, Azem, nuk fle?

AZEMI — Nuk i kam ulur qepallat fare. Tërë natën jam vërtitur nëpër shtrat, sikur flija mbi hithëra...

DANIA — Çfarë dite është sot?

KOZMAI — E diel...

AZEMI — E diel, e mërkurë, e premte, përsëri e diel! Rrimë duarkryq, numërojmë ditët dhe presim. Presim! Presim vaporin të sjellë kolonën teknike nga Odesa!... Presim përgjigjen e laboratorit të Moskës!

KOZMAI — Ç'mund të bëjmë tjetër?

AZEMI — Sikur t'i kishim dërguar kampionët për analiza në Qytetin Stalin, përgjigja do të kishte ardhur me kohë, dhe ne...

KOZMAI — ...Do të fitonim disa ditë dhe asgjë më tepër! Kurse përgjigjja e laboratorit të Moskës do të ndajë njëherë e mirë shapin nga sheqeri... Apo flas gabim, inxhinier?

GJERGJI — Edhe shokët sovjetikë prandai ngulën këmbë që analizat të bëhen në Moskë...

DANIA — Zemra ma thotë se kësaj radhe...

AZEMI — (*Gjerajit.*) Edhe ju njeri të shkathët gjetët për të dërguar në Tiranë. Në këmbë të ishte nisur do të kishte arritur deri tanë...

GJERGJI — Kushedi, rrugë i thonë...

DANIA — Se mos është motoçikletë... Ajo të lë në baltë kur të d'uash...

AZEMI — Plaça unë, Nikollai do të ketë shtypur

ndonjë patë dhe ia ka shtruar gjëkundi me votkë, ndërsa ne presim...

KOZMAI — Ule zérin se flenë të tjerët...

GJERGJI — Jo, jo, në dhomën e tyre s'ka njeri. Janë në këndin e kuq. S'kanë mbaruar mble-dhjen akoma...

AZEMI — (*I habitur.*) Nuk kanë mbaruar mble-dhjen?!

GJERGJI — Jo. Sonte nuk janë kthyer fare në bariangë...

AZEMI — Me inxhinierin e ri s'bëhet shaka, or vëlla! Ai s'të falka! Veçse duhet të jetë burri i zoti. E di si më tha dje në mëngjes? Ishim të dy në majë të ciplakut...

«Si thua ti, Azem, do t'ia rrëmbejmë naftën tokës?»

— Oj, të rrëmbyer, — i thashë, — «Me shqiptarët s'kisha punuar kurrë, më tha, por me ç'shoh, vullneti dhe pasioni juaj mund të bëjë mrekullira. Mrekullira...»

DANIA — (*Pas një heshtjeje të shkurtër.*) Inxhinier, ty, si ta ndien zemra? Nuk e di, tërë natën më buçiste në vesh zhurma e motocikletës së Nikollait. Kushedi sa herë jam ngritur në dritare...

AZEMI — S'ka faj, i gjori Dane, me atë të gërhitur që bën Kozmai, nuk është çudi që ndonjë ditë t'i dëgjohet si zhurmë vaporë. (*Qeshin.*) Inxhinier, më jep një cigare...

GJERGJI — Fli, Azem, është shpejt. Manovra mbrëmë na lodhi më shumë se asnijëherë tjetër...

DANIA - Inxhinier, nuk më dhe përgjigje... Si ta ndien zemra?

AZEMI - (*Ngrihet mbi shtrat*). E dëgjuat? Kohët e fundit, që kur është fejuar, Dania ka hruar shumë fjalë e ka nisur të përdorë fjalë të reja, si për shembull: zemra, sy ngjyrë qielli, hëna e fshatit, shpirti im etj. (*Qeshin*.) E ç'hyn zemra në naftë, o i uruar? Si e ndien laboratori thuaj... Apo flas gabim, Kozma, se ty të kemi edhe me shkollë... akshami, këtu...

GJERGJİ - Dane, në qoftë se gjatë kësaj kohe kemi pasur më tepër dëshira dhe shpresa, kampionët e fundit, që u dërguan në Moskë, na i kthyen ato në bindje. Unë jam i bindur se Nikollai do të ketë fatin i pari të na sjellë sihariqin...

DANIA - Ah, sikur...

AZEMI - ...Pastaj më thoni, mos i bjer më qafë!.. «Ah, sikur!»... thotë. Sikur... nuk ka më! Nikollai do të zbresë nga motoçikleta dhe do të bërtasë njëlloj si do të bërtasësh ti pas një viti, kur të kthehesh nga materniteti: Djalë! Djalë!

KOZMAI - Sa të lartë e ke atë të shkretë zë, o i uruar!

AZEMI - Ç'e do, kur s'u bëra këngëtar, inxhinier. Si thoni, mund të bëhej Azemi një këngëtar i shquar opere?

DANIA - E pse jo? Edhe këngëtarët njerëz janë...

AZEMI - Mendoni një çast. Salla plot e përplot me njerëz. Dritat shuhën ngadalë, nën tin-

gujt e muzikës hapet perdja dhe në skenë
del këngëtari më i shquar i kohës...

KOZMAI — Pastaj do të nisësh të çaplosh gojën
e të bërtasësh... Ore inxhinier, se ti ke parë
edhe andej, të drejtën, ato operat s'para i
honeps! Aaa, të thuash ndonjë popullore e
kam për borxh të rri e ta dëgjoj derisa të
ngryset. (*Qeshin.*)

DANIA — (*Thérret papritur.*) Erdhi! (*Ngrihet me
rrëmbim nga shtrati dhe afrohet pranë dri-
tares.*) Përsëri më bënë veshët...

AZEMI — E kam thënë unë, me ty e kemi keq
derisa të martohesh...

GJERGJI — Shtrihuni, djema, shtrihuni, është
shpejt. Sot do të kemi punë... (*Del nga dho-
ma dhe mbështetet pas parmakut duke vë-
shtruar i menduar larg në horizont.*)

KOZMAI — (*Nxjerr librin që ka poshtë jastëkut.*)
Mua nuk më flihet. Do lexoj pak.

DANIA — Kur i keni provimet?

KOZMAI — Erdhën, të shkretat.

DANIA — Vullnet të fortë ke, vëlla. Të kam zili.
Edhe sa provime të kanë mbetur?

KOZMAI — Edhe tre provime dhe merr fund kjo
punë...

GJERGJI — (*Me vete.*) E çuditshme! Pak më parë
qielli nxinte dhe dukej sikur do të niste
furtunë, kurse fare papritur u kthjellua si
të ishte natë vere... (*Ulet dhe diç shënon me
laps në projekt. Petroja hyn me një çantë
në dorë. Që larg vë re Gjergjin duke pu-
nuar, e sheh për një kohë të gjatë, pastaj
i afrohet ngadalë.*)

PETROJA — Gjergj, nuk paske fjetur sonte?

GJERGJI — Nuk të ndjeva fare. Përse erdhe në këtë orë?

PETROJA — Mbledhja e organizatës bazë të partisë zgjati deri në mesnatë...

GJERGJI — Mbledhja e organizatës bazë?!

PETROJA — Po. Kishte ardhur një shok i deleguar nga Komiteti Qendror i Partisë...

GJERGJI — Dhe ti erdhe në këmbë nga këndi i kuq i zonës? Përse nuk prite urbanin e mëngjesit? Ulu! Apo do të shtrihesh që të ghodhesh një copë herë...

PETROJA — Nuk kam nevojë. Shokët flenë?

GJERGJI — Jo, sonte asnjeri nuk ka vënë gjumë në sy. Të gjithë presin...

PETROJA — (*I menduar.*) Presin...

GJERGJI — Presin Nikollain... Ai duhej të vinte qysh mbrëmë...

PETROJA — Presin...

GJERGJI — Baba, ti seç ke sonte. Mos ka ndodhur gjë në shtëpi?

PETROJA — Asgjë!...

GJERGJI — Nuk është e vërtetë. Sytë e tu diçka fshehin...

PETROJA — (*Thërrret papritur i nervozuar.*) Përsëri i keni lënë ndezur dritat e këndit të kuq? Njëqind herë ju kam porositur. Hiç të kujdeshëm nuk jeni...

GJERGJI — Atje ka njerëz...

PETROJA — Njerëz?

GJERGJI — Po, shokët sovjetikë bëjnë mbledhje. Sonte nuk kanë ardhur fare në barangë. Siç duket, Viktorit i pëlqejnë shumë mbledhjet...

PETROJA — (*Si me vete.*) Mbledhjet...

GJERGJI — Të të bëj një çaj të ngrohtë?

PETROJA — Nuk dua asgjë...

GJERGJI — Baba...

PETROJA — Gjergj, ti je im bir, por sonte unë kam nevojë të flas ndryshe me ty...

GJERGJI — Unë...

PETROJA — Mos më ndërprit, por dëgjomë. Dëgjomë dhe mendohu mirë për të gjitha...

GJERGJI — (*Jo pa habi.*) Po të dëgjoj...

PETROJA — Rrugës takova Nikollain, motoçikleta i ishte prishur lart në kthesë dhe kishte disa orë që priste...

GJERGJI — (*I tronditut nuk e lë të vazhdojë më tej.*) Nuk është nevoja të ma thuash me fjalë, atë që sytë e tu ma thanë sapo erdhe. (*Hesh-tje e shkurtër.*) Pra, edhe kësaj radhe përgjigjja erdhi negative?

PETROJA — Po. (*Nxjerr nga valixhja dokumentet e laboratorit dhe ia jep.*) Ja tek janë. M'i dha mua t'i sillja, ndërsa ai ngarkoi motorin në një zetor dhe shkoi në qytet...

GJERGJI — (*Lexon në heshtje.*) Si është e mundur? Këtë nuk e prisja kurri! Vdekjen mund ta mendoja, por... (*Lexon nëpër dhëmbë:*) «Moshë paleogen... mundet oligocen...» E pabesueshme!...

PETROJA — Gjergj, kapiteni i mirë në furtunë dallohet!

GJERGJI — (*Më tepër vetes.*) Kapiteni i mirë!... Kësaj radhë anijes sime uji po i futet nga të gjitha anët dhe ajo zhytet gjithnjë e më thellë drejt fundit...

PETROJA — (*Shperthen papritur.*) Atëherë merr gomën; hidhe në det dhe shpëto lëkurën tënde! Gjergj, mblidh veten, burrat nuk e humbasin kurrë torruan.

GJERGJI — Gabohesh. Unë nuk kam frikë. Unë nuk trembem për veten time. Mua më vjen keq, më dhemb këtu, baba! (*Rreh gjoksin.*)

PETROJA — Të thashë, sonte nuk flas me ty si baba...

GJERGJI — (*I pafugishëm.*) Ja pra më në fund edhe... disfata!

PETROJA — (*Kercënues.*) Gjergj!...

GJERGJI — (*Pas një heshtjeje.*) Ljuba kishte të drejtë. E tërë kjo histori përmblidhet në një fjalë të vetme: Disfatë!

PETROJA — Ljuba?

GJERGJI — Po, po... Disfatë. Çdo emër tjetër është një ngushëllim i rremë. Kohët e fundit ajo gjithmonë më thoshte... Kurse unë...

PETROJA — Kohët e fundit? Ç'të thoshte Ljuba kohët e fundit?

GJERGJI — (*Më tepër vetes.*) Në zonën e parë punimet vazhduan një vit të tërë... Një vit ëndrra, shpresa, miliona lekë! Plot një vit djersë, pagjumësi, një vit sakrificë, pastaj erdhi fundi i pamëshirshëm: dështimi! Kryqi dhe çdo gjë fluturoi në erë. Zona ishte shterpë. Dhe mos harroni, autor i projektit isha unë. (*Heshtje.*) Megjithatë unë nuk e humba besimin te njerëzit, te vetja. Ne përsëri filluam punimet në zonën e re dhe punët nisën mbarë. Çdo gjë fliste për naftë. Shpresa ndriçonte çdo ditë e më shumë sytë

e të gjithëve. Shpresa... Dhe fare papritur, taman si në përrallë, filli i shpresave këputet dhe ato rrrokullisen thellë në greminën e dështimit. (*Hesht një çast.*) Si është e mundur? Baba, ti ke një jetë të tërë që përfytesh me naftën, si është e mundur? (*Hesht një çast.*) Po, po, Ljuba kishte të drejtë...

PETROJA — Fjalët e tua janë pjellë e dëshpërimit, Gjergj! Ndërsa fjalët e gruas sate... ato fjalë, janë njëlloj si t'i fshehësh pushkën burrit që përcjell për në luftë...

GJERGJI — Unë e kuptoj, ti kërkon me çdo kusht të ngushëllosh tët bir!?

PETROJA — As që më shkon ndër mend. Dua vëtëm të të kujtoj diçka... Kur ishe i vogël ti rrije me orë të tëra në prehrin tim dhe unë të tregoja histori të ndryshme. Plot kureshtje ti më dëgjoje gojëhapur dhe nuk m'i shqisje sytë e vegjël. Vitet shkuan dhe jeta bëri të sajën. Unë u thinja ndërsa ti u bëre burrë. Tani në prehër nuk të mbaj dot si dikur, por një histori të shkurtër, të cilën ti e pël-qeje aq shumë, dua të ta kujtoj:

«Pas një beteje të ashpër me gjermanët ne u futëm në kishën e djegur për të kaluar natën. Drita nuk kishte zbardhur mi-ë, kur njëri nga shokët që bënte roje, thirri: «Shoku komandant, gjermanët na kanë rrethuar!» (*Heshtje, Gjergji i ka ulur sytë për tokë.*) C'duhet të bënim ne atëherë? Të ngrinim duart lart? (*Hesht një çast.*) Përse nuk më sheh në sy, Gjergj?

GJERGJI — Usta Petro...

PETROJA — Në sy, në sy të thashë, shikomë!

GJERGJI — Unë... E tërë kjo erdhi kaq papritur...
Si është e mundur, baba? Këtu çdo gjë flet
për naftën?

PETROJA — Gjergj! Përgjigja e laboratorit të
Moskës erdhi negative. Por ne shpimin do ta
vazhdojmë më tej, pavarësisht nga përgjigjja.

GJERGJI — Si?

PETROJA — Po. Ky është vendim i organizatës ba-
zë të partisë...

GJERGJI — Si t'i kuptoj fjalët e tua? Shokët sovj-
tikë e kanë dhënë prerë mendimin e tyre...

PETROJA — E, megjithatë, ne nuk do t'i ndërpres-
sim punimet...

GJERGJI — Baba, sonte më dukesh më i pakup-
tueshmë se kurrë! Unë nuk jam në gjendje
të them...

PETROJA — Nuk pres të më thuash asgjë. Pres
vetëm që ti të jesh trim dhe këmbëngulës!
Të mos e humbasësh për asnje çast besimin
tek vetja dhe punëtorët që të rrrethojnë...
*(Heshtje. Petroja nxjerr nga çanta një copë
byrek të mbështjellë me letër.)* Merre! Është
byrek me kungull. Jot ëmë ma futi me pahir
në çantë. Kjo është hisja jote...

GJERGJI — Nuk më hahet...

PETROJA — Ku shkon?

GJERGJI — As unë s'e di. Ndoshta tek Viktori.
Kur ta marrë vesh edhe ai do të dëshpë-
rohet. Ai ishte aq optimist...

PETROJA — *(I menduar.)* Viktori!... Gjergj, biri
im! Shkojmë në barangë tek shokët. Shkoj-

më. Sonte kemi për t'i thënë shumë gjëra njëri tjetrit...

GJERGJI — Shko ti, baba. Unë do të rri pak në breg të lumit, në ajër të freskët, pastaj do të vi në barangë... (*Niset ngadalë.*)

PETROJA — Gjergj, të presim!

GJERGJI — Nuk vonohem. (*Del.*)

PETROJA — (*Thith gibukun i menduar dhe vë-shtron në drejtim të Gjergjit.*) Është i ri, i pastër dhe nuk mund ta marrë me mend se... Jo, jo, ai s'ka faj! E kush mund të mendonte se... (*Nga ana e këndit të kuq dëgjohen zëra.*) Ata po dalin nga mbledhja. Duhet të bisedojmë me shokët përparrë se të bëhet mbledhja e përbashkët. (*Niset për në barangë ku janë punëtorët.*)

DANIA — Usta Petro... (*Të gjithë ngrihen nga shtretërit.*)

PETROJA — (*Zë vend ndërmjet tyre.*) Djema...
(*Bie perdja.*)

(Natë. *Shi. Diku në afërsi të barangës ku ruhen arkat e kampioneve, Viktori hyn tok me Aleksejin e Vasilin. Përgjon një çast pastaj i drejtohet Vasilit.*)

VIKTORI — Kështu pra, Vasia...

VASILI — Shoku Viktor, përse pikërisht unë?

VIKTORI — Kuqo, tek ti nuk i shkon kujt mendja për të keq. Varrimin e kampioneve gjithmonë ti e ke bërë...

VASILI — Unë...

VIKTORI — Ke frikë?

VASILI — Po, kam frikë.

VIKTORI — Tani të gjithë flenë. Gjergjin e dëgjove, ai më pret mua tek pusi. Kujt i trembesh tjetër?

VASILI — Vetes!

VIKTORI — Çfarë?

VASILI — Vetes! Vasilit! (*Qëllon gjoksin.*) Kësaj këtu. Ja se kujt i trëmbem...

VIKTORI — Vasja, nuk është as vendi as koha për gjepura të tilla! (*I jep çelësin.*) Merre!

VASILI — Kam një jetë të tërë që punoj në naftë. Një jetë të tërë dhe në naftë dua të vdes. Por dua të vdes i ndershëm... I ndershëm, siç kam qenë tërë jetën. Përse kërkoni që njerëzit të më shohin me neveri, të më përbuzin? Përse kërkoni të më njolloşni me një turp të tillë?

VIKTORI — Vasja, siç duket nuk të mjaftoi një natë e tërë? Shqiptarët kanë tradhtuar. Udhëheqësit shqiptarë kanë tradhtuar Partinë Komuniste mëmë të Bashkimit Sovjetik. A nuk janë të mjaftueshme këto për të qetësuar ndërgjegjen tënde?

VASILI — Inxhinier, unë kam vite që jetoj me shqiptarët. Ata janë njerëz të drejtë, të mirë, njerëz...

VIKTORI — E kush i mendonte ndryshe? Njerëzit nuk janë gjithmonë ata që hiqen! (*Heshtje një çast.*) Sidoqoftë ata do të pendohen për të gjitha. Ata nuk mund të jetojnë dot asnjë ditë pa ndihmën tonë. As edhe një. Bllokada jonë do të jetë e pamëshirshme. Pa bukë, pa naftë, ata do të bien në gjunjë përpara këm-

bëve tona dhe do të na shtrijnë dorën pér bukë.

VASILI — (*Me vete.*) Bllokadë!?

VIKTORI — Pastaj çdo gjë do të qetësohet dhe do të normalizohet përsëri. Pra, e tërë kjo është e përkohshme, Vasja. E përkohshme, përderisa shqiptarët të futen përsëri në vathën tonë. (*Hesht një çast.*) Merre! (*Vasili e vështron në sy i shtangur.*) Lëri marrëzitë dhe mendohu mirë pér lëkurën tënde, pér fëmijët e tu. Mos harro, Siberia nuk është larg as pér ty as pér njerëzit e tu. Ti më njeh mirë mua. Unë atë që them e bëj. Në rast të kundërt, mbaji mend mirë këto fjalë... (*Hesht një çast.*) Dy rrugë janë: ose me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ose kundër saj! (*I lëshon çelësin e dhomës në dorë. Largohet prej tij.*)

VASILI — (*Vështron çelësin i tronditur thellë në shpirt.*) Siberia nuk është larg as pér ty as pér njerëzit e tu. Dy rrugë janë: ose me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ose kundër saj! Zgjidh pra, Vasja... Sytë t'i lidhët me një shami të zezë dhe të thanë: Ec! Zgjidh cilën rrugë të duash! Ndryshe... (*Psħerettin thellë.*) Ah, Vasja, Vasja!... (*Afrohet ngadalë tek shkallët e barangës ku ruhen arkat e kampionëve.*)

(*Duke u laðguar Aleksej me Viktorin.*)

ALEKSEJ — (*Nën zë.*) Shoku. Viktor, pérse e gjithë kjo? Këtë punë e kisha mbaruar unë!

VIKTORI — Jo, jo, ti. Ai, ai dhe askush tjetër. Kjo

natë duhet t'i japë fund njëherë e përgjithmonë përpëlitjeve të këtij njeriu. Pas kësaj nate ai nuk mund të kthehet më prapa. Për njerëz të lëkundur nuk kemi nevojë. (Dalin.)

VASILI — Ata po flenë... (*Ngjit shkallët e drunjta. hap derën dhe futet në dhomë. Merr arkën me kampione dhe del. Zbret shkallët me shpejtësi dhe i tërbuar vrapon drejt lumit. Nga ana tjetër e skenës hyn Gjergji. Ai ndjek i hutuar për një kohë të gjatë largimin e Vasilit.*)

GJERGJI — (Me vete.) Kuqoja ishte! Ç'kérkon Vassja në këtë orë tek dhoma e kampioneve? Përse vrapon me arkë në dorë në drejtim të lumit? (*Me shpejtësi ngjit shkallët dhe hyn në dhomë. Ngre një arkë, pastaj një tjetër, një tjetër.*) Kampionet e fundit mungojnë! (*Jashtë dëgjohen hapa. Gjergji qëndron palevizur. Heshtje e gjatë. Ai pret. Vasili kthehet në skenë me arkën bosh. Ngjit shkallët, hyn me kujdes në dhomën e kampioneve dhe pasi vendos arkën bosh në vendin e mëparshëm, radhit mbi të arkat e tjera me kampione. Papritmas shtanget. Drita e dhomës hapet dhe ai e sheh veten ballë për ballë me Gjergjin.*)

VASILI — Unë...

GJERGJI — I pashë të gjitha...

VASILI — Unë erdha... erdha për të varrosur kampionet e vjetër...

GJERGJI — Si? (E mbërthen për gryke.) Kampionet e fundit ku janë? (Merr arkën e derdh

kampionet te këmbët e Vasilit.) Ku i shpurre kampionet e fundit?

VASILI — (*I tronditur.*) Unë...

GJERGJI — Nuk të paskam njohur mirë, Kuqo...
Përse hesht? Eja me mua. Le ta marrin vesh
të gjithë se...

VASILI — Mos! Prisni inxhinier. Mos! (*Heshtje.*)
Unë i hodha kampionët në lumë...

GJERGJI — Thuaj që je i dehur, Vasja, thuaj...

VASILI — Nuk jam i dehur, Gjergj...

GJERGJI — Nuk është e mundur. Atëhere je i çmendur!

VASILI — Jo, unë... Ai!

GJERGJI — Cili?

VASILI — Viktori!

GJERGJI — Hesht! Ti gënjen...

VASILI — Jo, Gjergj. Heshtja do të ishte gënjeshtë...

GJERGJI — Përse e bëre këtë, Vasja? Përse? (*Heshtje.*)

VASILI — As unë s'e di...

GJERGJI — Turp, turp të kesh, Kuqo!

VASILI — Gjergj!...

GJERGJI — Sa i pështirë dukesh...

VASILI — Edhe këtë e di...

GJERGJI — E di?

VASILI — Po. Të paktën dëgjomë, pastaj më gjyko.
Kjo që do t'ju them rëndon mbi mua më tepër
se kjo që ndodhi! E di...

GJERGJI — Flisni...

VASILI — Unë luftova, luftova një natë të tërë me
ata dhe me veten time. Luftova dhe humba.

Unë humba dhe fitoi frika. Ju nuk e njihni mirë atë. Ai është i tmerrshëm, inxhinier Gjergji! Në fillim qdo gjë nisi qetë, natyrshëm. Përgjigjja nga Moska pritej negative...

GJERGJI — Pritej negative?!

VASILI — Mos më ndërprisni. Pritej. Ndoshta shqiptarëve u hipte në kokë të dërgonin në laboratorin e tyre të njëjtat kampionë! (*Hesht një çast.*) Pra, unë duhej të shkëmbeja kampionët dhe ju të ngrinit duart përparrë përgjigjies së Moskës. Kjo është e gjitha...

GJERGJI — (*I trondit*.) Ti flet përcart!

VASILI — Jo, Gjergi. aspak. Unë nuk kuptoi shumë gjëra po erën pabesisë ia ndiej. Erën e saj kam ditë që e ndiej...

GJERGJI — Pabesisë?

VASILI — (*Më tepër vetes.*) Rusia i ngjan një të dehuri që i merren këmbët dhe duket sikur do të bjerë nga çasti në çast, po se ku? As ajo vetë s'e di! (*Heshtje e shkurtër.*)

GJERGJI — Fjalët e tua më vijnë ndër mend...

VASILI — Dhe tani një lutje të fundit, inxhinier. Ti je djale i ndershëm, i drejtë, prandaj shpresoj se do të më besosh. Kuqoja nuk ishte i poshtër. Ai u bë i tillë... (*Largojet.*)

GJERGJI — «Pabesi»! Jo, jo, nuk jam në ëndërr! «Pabesi»!.... (*Shpërthen.*) Çfarë po ndodh kështu? Çfarë po ndodh? (*Del me vrap.*)

* *
*

Ambient i aktit të dytë.

'Në skenë është Petroja. Gjergji hyn dhe vërsulet në drejtim të tij.

GJERGJI — Baba!?

PETROJA — Gjergj, ç'u bëre deri tani? Ku ishe?

GJERGJI — Baba!

PETROJA — Ç'është?

GJERGJI — (Stepet sepse në skenë menjëherë, pas kurritit të Petros, shfaqet Viktori.) Asgjë.
(Largohet me vrap në drejtim të lumit.)

VIKTORI — (E thërret me zë të lartë.) Gjergji!
Gjergji! I shkreti... Gjergj! E marr me mend dëshpërimin e tij. Pak më parë e pashë në breg të lumit. I fola që larg. Po ai nuk më dëgjonte. Rrinte atje i vetmuar dhe mendohet... Dhe s'ka faj! Përgjigjja e laboratorit të Moskës për të gjithë ishte e papritur! (I zgjat paketën.) Ndize!

PETROJA — Nuk dua...

VIKTORI — I gjori Gjergj! S'më hiqet nga mendja tronditja e tij! Ai pandeh se në jetë...

PETROJA — (Drejt në sy.) Të gjithë njerëzit janë ashtu siç hiqen...

VIKTORI — Çfarë?

PETROJA — (Drejtohet nga baranga.) Azem!... O Azem!

VIKTORI — Shoku Petro!... (*Azemi del nga dhoma me peshqir në dorë.*)

AZEMI — Urdhëro usta!

PETROJA — Thuaju të gjithë shokëve të mblidhen në këndin e kuq...

AZEMI — Menjëherë usta... (*Del në drejtim të këndit të kuq.*)

VIKTORI — Shoku Petro! (*Del me nxitim pas Petros.*)

AZEMI — (*Me vete.*) Asnjë fjalë s'foli Zamuhini! (*Zhduket pas barangës ku ndodhet qendra e zërit. Zëri i tij dëgjohet në altoparlant.*) Vini re! Vini re! Të gjithë të mblidhen në këndin e kuq. Vini re! Vini re! Ore Dane, ngreu shpejt se të ka ardhur nusja! Ngreu, lumëmadh, se do të të gjejë të zhveshur me brekë të gjata dhe do të të lërë fare...

DANIA — (*Ngrihet me rrëmbim nga shtrati.*) Këtij njeriu ia kam zili optimizmin...

KOZMAI — (*Qesh.*) Të jetë bykë nga mendja, thuaj...

ZËRI I AZEMIT — (*Në altoparlant.*) Vini re! Vini re! Jù flet qendra e zërit... Kozma, o shkencëtar i pazbuluar i brigadës, ngreu se ka ardhur për shfaqje Teatri i Operas dhe i Baletit...

DANIA — Ty ta ka gjetur bukur, ama...

KOZMAI — Eh, ç'më është qepur me ato operat, zuzari...

ZËRI I AZEMIT — (*Në altoparlant.*) Viñi re! Vini re! Të gjithë në këndin e kuq!

(Pastaj në altoparlant dëgjohen tingujt e një muzike gazmore. Dania dhe Kozmai zgresin shkallët. Pas tyre vjen Aleksej.)

KOZMAI — Mirëmëngjes, Aljosha!...

ALEKSEJ — (Ftohtë.) Mirëmëngjes!...

AZEMI — (Duke hyrë.) Fjete ndonjë çikë sonte?

KOZMAI — Ku të flinte? Në mbledhje?

AZEMI — Aljosha është nga njerëzit që i shijon mbledhjet më shumë se kushdo. Apo jo, Aljosha? Sa herë që bëhen mbledhje zë rrëzën e këndit të kuq dhe ia mbështjell gjumit. (Të qeshura.) Apo s'i dalin në ëndërr gjithmonë pata, të varfërit. Me gjithë mend, Aljosha, thuaj si të duash, por ti në çdo mbledhje e përlan nga një patë! (Të qeshura.)

ALEKSEI — (I nxehur.) Karagjoz!

AZEMI — (I fyter.) Si?

DANIA — (Ndërhyjn me shpejtësi.) Azem!... (Aleksej del. Heshtje e gjatë. Ata dalin ngadalë njëri pas tjetrit. Në skenë dëgjohen vetëm tingujt e muzikës që shpërndahen nga altoparlanti, i cili është vendosur mbi çatinë e barangës. Nga larg dëgjohet zëri i Ljubës.)

ZËRI I LJUBËS — Gjergj! Gjergj! Hej, a ka njerëz në barangë?

(Ljuba hyn në skenë. Ajo mban në kokë një kapelë gëzofi, ndërsa në sup i varet një aparat fotografik. Ecën duke kërkuar me sy rreth e rrotull.) Gjergji! Ej, a ka njerëz në këtë barangë?

(Ajo ngjit shkallët dhe sheh dhomat e bosha-

tisura. Pastaj zbret përsëri. Përballë saj vjen Gjergji. Ai ecën ngadalë, i menduar dhe sytë nuk i shqiten nga kampioni që mban në duar.)

LJUBA — Gjergj! (*Ajo vrapon dhe i hidhet në qafë. Ai e vështron në sy, i hutuar dhe hesht.*) Gjergj! Nuk më njeh? (*Qesh.*) Ti nuk më dukesh mirë! Cfarë të ka ndodhur? Ulemi, Gjergj! (*I fut krahun dhe të dy ulen.*) Gjergj, ty të flas. Përse hesht? Të paktën më shih në sy! (*Ai e vështron në sy.*) Ti nuk je mirë. Jo! Sytë të janë futur thellë dhe rrëth e rrotull të janë nxirë... (*Ljuba i hedh Gjergjit krahun në qafë. Papritur ajo vë re kampionin që mban në dorë dhe ia rrëmbe.*) Ky është kampioni? Po, po. Tani të gjitha i marr me mend! Sytë e tu i njoh mirë. Ata e shprehin hapur dëshpërimin tënd! (*Heshtje.*) Pra, erdhi përgjigja nga Moska? (*Gjergji merr kampionin ngadalë nga duart dhe ngritet.*) Gjergj, ti po më çmend! Përse sillesh me mua në këtë mënyrë?

(*Dëgjohet boria e autobusit që është ndalur larg në rrugë, diku pranë barangës. Ljuba vrapon. Ngjitet te parmaku dhe lëviz dorën në drejtim të makinës.*)

Erdha! Erdha! (*Kthehet përsëri pranë Gjergjit.*) Gjergj, shoqet më presin, ato e kthyen autobusin deri lart në rrugë vetëm për mua! U bënë kaq net që nuk ie kthyer në shtëpi. Unë erdha e malluar të të shoh një cast ndërsa ti... O zot, ti, ose je çmendur, ose ke vendosur të më shkallosh me heshtjen tën-

de! (*Përsëri dëgjohet boria. Ljuba afrohet me nxitim tek parmaku dhe përsëri u a bën me shenjë shoqeve.*) Erdha! Erdha! Gjergji, unë po iki! Ti ke vendosur të mos më flasësh asnje fjalë? Veç mos harro, inati im është më i pamëshirshëm se kokëfortësia jote! (*I afrohet pranë duke ndërruar ton.*) Gjergj, më puth. Nuk të ka marrë malli për Ljubën? (*E puth në faqe ndërsa Gjergji qëndron si i gurtë.*) Unë po shkoj. (*Përsëri dëgjohet boria.*) Kur të kthehem nga ekskursioni, të të gjaje në shtëpi! Dëgjon? Dasfidanja! (*Largolet me të shpejtë tek makina.*)

GJERGJI — (*Me vete.*) «Unë nuk di shumë gjëra, po erën pabesisë ia ndiej...»

AZEMI — (*Hyn.*) Unë të kërkoj në qiel kurse ti paske zbritur në tokë. Qenke futur në të thella, Gjergj! (*I afrohet pranë.*) S'kam lënë vend pa të kërkuar. Të gjithë janë mbledhur në këndin e kuq.

GJERGJI — Azem, bëre shumë mirë që erdhe. Usta Petros i thuaj që e pres këtu. Të vijë patjetër!

AZEMI — Të vijë këtu?!

GJERGJI — Të lutem! Veç njeri tjetër mos të të dëgjojë. Shko, Azem. (*Azemi del duke ngri-tur supet. Gjergji përsërit me vete.*) «Përgjigjja pritej negative nga Moska... Ndoshta shqiptarëve u shkrenet në kokë t'i bëjnë përsëri analizat e kampionëve dhe...»

PETROJA — (*Hyn dhe thërret i nervozuar.*) Gjergj, ç'janë këto marrëzira?

GJERGJI — Baba!... Sovjetikët hodhën kampionët

e fundit në lumë dhe në ato arka vendosën kampionë të rrremë...

PETROJA — Eja në vete, Gjergj...

GJERGJI — Kam një orë të tërë që përpinqem, baba, por qenka vështirë, tepër vështirë...

PETROJA — Sovjetikët?!

GJERGJI — Po. Vasili! Unë e pashë atë me sytë e mi dhe e mbërtheva ja, këshfu, për gryke...

PETROJA — Deri këtu?

GJERGJI — Ai tha se e kishte detyruar Viktori...

PETROJA — Viktori?! Jo bir, jo!

GJERGJI — Ai...

PETROJA — Ai Vasil që vite më parë nuk kurseu as gjakun, as jetën kur dëgjoi thirrjen e Stalinit, ai sot... u përkul, u gjunjëzua përrapa poshtërsisë!...

GJERGJI — Baba!

PETROJA — E, pra, gjunjët e shqiptarit s'e kanë prekur baltën kurrë. Shqiptari ka ecur në këmbë, ballë lartë nëpër urën e vdekjes, vetëm për të mos rënë poshtë në pellgun e tradhtisë.

GJERGJI — Tradhtisë?!

PETROJA — Po, bir, tradhti! Njëlloj si atëherë në vitin 48. Një lloj. Vetëm fytyrat ndryshojnë! Atëherë dhe ata pandehën se do ta gjunjëzonin Partinë tonë... (*Heshtje. Gjergji është shtangur.*)

GJERGJI — (Me vete.) Inxhinier Zamuhini!...

PETROJA — (E ndërpret.) Ai nuk ka asgjë të përbashkët me një inxhinier të ndershëm. Asgjë! Konfliktet, gjoja me karakter teknik që ai dhe ustallarët e tij përpinqen të tri-

llojnë vonesën e kolonës teknike tre muaj me radhë, analizat e kampioneve në Moskë, të gjitha këto i kanë rrënjet në të njejtin vend. Atje. Në Konferencën e Moskës!

GJERGJI — Në Konferencën e Moskës?

PETROJA — Po, Gjergj. Atje. Udhëheqja sovjetike kërkon të gjunjëzojë Partinë tonë. Ata duan që Partia e Punës e Shqipërisë të tradhtojë marksizëm-leninizmin, të tradhtojë popullin e saj, të tradhtojë revolucionin dhe të hipi bashkë me këlyshët e tyre në qerren revolucioniste! (*Heshtje.*) Dhe tani, s'më thua, Gjergj, në qoftë se 17 vjet më parë, ti do të ishe në vendin tim atje tek kisha e djegur dhe njëri nga rojet partizane do të të drejtohej: «Shoku komandant, gjermanët na kanë rrethuar!» (*Heshtje.*) Çfarë do t'u thoshe partizanëve, shokëve të tu?

GJERGJI — (*I menduar.*) Rrëmbeni pushkët, shokë! Rrethimin ta çajmë me luftë!

PETROJA — Luftë, Gjergj, luftë! Tamam si atëherë. Vëç tani është pa pushkë, pa bomba, pa krisma. E heshtur po e ashpër. Shantazhet, presionet, bllokadat, ja cilat janë armët e tyre në këtë luftë

...

GJERGJI — Dhe ne, si atëherë, përsëri do të fitojmë, baba! Përsëri!

PETROJA — Po, bir, me Partinë tonë ne kurdoherë do të fitojmë. (*Heshtje.*) Dhe tani shkojmë, Gjergj. Shokët na presin. (*Me ironi.*) Edhe inxhinier Zamuhini na pret. I varfëri Zamuhini

hin!... I pikelluar nga përgjigjja negative e laboratorit të Moskës... Na pret me lot në sy, të na mbushë mendjen me argumente shkençore që t'i ndërpresim punimet, pasi edhe kjo zonë është... shterpë si e para.

GJERGJI — (*Duke shtrënguar nofullat.*) Inxhinier Zamuhini!

PETROJA — Dhe tani përpara se të shkojmë, dëgjomë edhe një fjalë. Këto që ndodhën sonte, veç teje askush nuk duhet t'i marrë vesh. Askush. Mos harro, Gjergj, ne duhet t'i shmangemi me çdo kusht incidenteve që ata mund të provokojnë. Për këtë porosita edhe shokët e tjerë.

GJERGJI — Tani...

PETROJA — Gjergj, tani më tepër se kurrë duhet t'i hapim sytë mirë! Ti je djalë i mençur vetë! Mos harro, Ljuba...

GJERGJI — (*E ndërpret.*) Ljuba? (*Në dhomë hyn Viktori me rrëmbim.*)

VIKTORI — Shoku Petro, ç'është kjo sjellje? Ne ju presim në mbledhje ndërsa ju...

PETROJA — Shkojmë, Gjergj. (*Gjergji merr kampionin që e kishin lënë mbi tavolinë dhe del pas të atit. Aljosha shtanget kur i sheh kampionin në dorë.*)

ALEKSEJ — Shoku Viktor! (*Bie zilja e telefonit. Viktori e merr.*)

VIKTORI — Alo! Po, zona e dytë.. Si? Të njoftojmë mensën që të gatuajë edhe për një brigadë tjetër? Çfarë? Çfarë? Si?... Brigada e Islamit do të punojë së bashku me ne për

të vazhduar shpimin më tej? Si!... (Përplas receptorin fort.)

ALEKSEJ — Shoku Viktor...

VIKTORI — Fol, ç'do më thuash?

ALEKSEJ — Ne vërtet i zhdukëm në lumë kampionët e fundit dhe në vend të tyre vumë kampionë të rremë, por ata, ata kanë ndër duar një kampion të vërtetë...

VIKTORI — (I habitur.) Si?

ALEKSEJ — Po, shoku Viktor. Gjergji e kishte ndër duar. Një javë më parë ai e kërkoi dhe unë ia dhashë atij me dorën time!...

VIKTORI — Dhe ti ke heshtur deri tani?

ALEKSEJ — Unë, të them të drejtën... (Duke iu marrë goja.) Mua më kishte dalë fare nga mendja! Pak më parë ia pashë në dorë dhe u kujtova menjëherë...

VIKTORI — (I shqetësuar.) Gjergji?!

ALEKSEJ — Shoku Viktor, atyre as që u shkon ndër mend një gjë e tillë... Sidoqoftë...

VIKTORI — Sidoqoftë një pakujdesi e tillë mund të na kushtojë shumë shtrenjtë. Ajo copëz e vogël prej balte është një varr i cili na merr të gjithë brenda...

ALEKSEJ — (I shqetësuar.) Ju mendoni...

VIKTORI — Unë mendoj për gjithçka. (Pas një heshtjeje të shkurtër.) Ai kampion duhet zhdukur me çdo kusht nga duart e Gjergjit! Me çdo kusht!..

ALEKSEJ — Tani edhe unë e kuptoj... Po, si, në ç'mënyrë?

VIKTORI — Ljuba!... Ljuba është e vetmja shpresë!?

AKTI I TRETE

Dekori i njëjtë si në aktin e parë, por kësaj radhe në apartament ndihen ndryshime. Ljuba, e veshur me një rrobdeshambërtë ri ngjyrë qielli, është ndalur përballë tablosë me ngjyra vaji e cila paraqet një moment nga Lufta Nacionalçirimitare. Ajo hipën në një karrige, heq tablonë dhe në vend të saj vendos një peizazh me pamje nga Moska. Pastaj zbret nga karrigia dhe vështron e kënaqur muret e zbulkuuar të dhomës. Ndërkojë dëgjohet zilja e telefonit.

LJUBA — (Merr receptorin.) Alo! Ljuba jam. Kush? Ahaa, nuk ta njoha zérin, Viktor. S'dëgjohet mirë. Si? Vetëm. Fare vetëm... Gjergji sapo doli. Jo, jo, nuk qëndroi as pesë minuta. La

valixhen dhe iku si era. Tha se kishte një mbledhje urgjente të këshillit teknik. Po, po. Mirëse të vish! Po të pres...

(*Dëgjohen trokitje në derë.*) Kush është?

ZËRI I KATINËS — «Hape, jam unë, të keqen...»

LJUBA — (*Përplas receptorin pas telefonit dhe flet nëpër dhëmbë me neveri.*) Edhe kjo... ku e pruri kokën tani!... (*Hap portën.*) Mirëse erdhe, nënë!

KATINA — (*Mban në duar një kanistër me rroba të lara. Vështron një çast e habitur Ljubën.*) Vajza që më solli rrobat për t'i larë, më tha se ishe e sëmurrë, prandaj dhe unë...

LJUBA — I solle?

KATINA — I solla. (*Lë kanistrën mbi tavolinë.*) I kam palosur të gjitha. Ja tek i ke. Vec për të hekurosur nuk i hekurosa dot se na u pre korenti. I solla mbasi ti i doje domosdo për në drekë...

LJUBA — Dhe i prure pa hekurosur?!

KATINA — Të thashë, o bijë...

LJUBA — Mirë, mirë, shpjeri në kuzhinë...

(*Katina shpie kanistrën e rrobave në kuzhinë, ndërsa Ljuba kërkon diçka në borset. Pas pak hyn Katina dhe vë re valixhen e Gjergjit.*)

KATINA — Gjergji qenka kthyer nga zona?

LJUBA — U kthyesh më në fund. La valixhen dhe u zhduk përsëri. Ndërsa unë gdihem dhe ngrysem e vetme brenda këtyre mureve...

KATINA — Mos u mërzit, të keqen. Bëj durim. Do zoti dalin faqebardhë, thuaj... pa...

LJUBA — Se mos të të shpëtojë goja dhe i thua

Gjergjit që të solla rrobat në shtëpi për t'i larë?

KATINA — Jo, bijë, jo, nuk i them... E di nëna...

LJUBA — (*I zgjat një kartmonedhë njëqindlekëshe.*) Merre këtë dhe shko në shtëpi tanis...

KATINA — (*E habitur.*) Ç'i ke ato?

LJUBA — Para... nuk i sheh?

KATINA — Para?!...

LJUBA — Merri!... Blej ndonjë pako kafe me të...

Ç'më sheh ashtu? T'i kam falur...

KATINA — (*E tronditür.*) Edhe këtë ma bëre, o nuse? Edhe këtë?

LJUBA — (*Përpinqet të ndryshojë situatën e krijuar.*) Nënë!...

KATINA — Nënë?! Guxon të më quash nënë?

(*Shpërthen.*) Vdekja më mirë se... sa... Ah, bir, bir, të keqen nëna!... Kishte hak im shoq, kishte hak...

LJUBA — Nënë... qetësohu!... (*E kap për krahësh.*

Kërkon me çdo kusht ta qetësojë.) Nënë, të lutem!... Unë të dua njëlloj si nënën time...

Unë nuk kisha asnje qëllim...

KATINA — Lëshomë udhë!... (*Del.*)

LJUBA — Këta të gjithë janë të çmendur! O zot, ç'të keqe paskam bërë në jetë që më hodhe ndërmjet këtyre? O, zot!?... (*Viktori hyn pa u vënë re.*)

VIKTORI — Nuk është shenjë e mirë kur njerëzit fillojnë të flasin me vete... (*Ljuba trëmbet.*) Ljuba, çfarë ka ndodhur?

LJUBA — (*Përpinqet të zotërojë veten.*) Asgjë, asgjë... Urdhëro, Viktor!... Ulu!...

VIKTORI — Koha nuk më premton të rri gjatë...

LJUBA — Ti kërkove të flisje me mua!?

VIKTORI — Po, prandaj erdha. Sajova një pretekst, dola nga mbledhja e këshillit teknik vetëm e vetëm se duhej të takohesha me ty përpara se Gjergji të vinte në shtëpi...

LJUBA — Ç'është gjithë kjo urgjencë? Çfarë ka ndodhur?

VIKTORI — Diçka të pyeta në telefon, por shpejt u pendova. Këtu edhe muret kanë veshë...

LJUBA — Asnjëherë nuk të kam parë të turbulluar si sot. Fol, po të dëgjoj...

VIKTORI — Gjergji... solli valixhen e tij në shtëpi?

LJUBA — (E *habitur*.) Pse?

VIKTORI — Ljuba nuk kam kohë pér...

LJUBA — Po. E pruri. Në dhomën tjetër është.

VIKTORI — Bukur!...

LJUBA — Unë...

VIKTORI — Tani mos më ndërprit por dëgjomë me vëmendje... (*Heshtje*.) Kështu si rrrohdhën ngjarjet, plani ynë pér zonat e reja është në prag të dështimit... Shqiptarët, me bindjen e tyre të verbër, kërkojnë të vazhdojnë shpimin më tej... dhe nuk do të jetë e largët dita kur ata do të prekin shtresën e naftës.

LJUBA — (E *habitur*.) Disa ditë më parë ju më thatë se...

VIKTORI — Ato që të kam thënë nuk kanë asnje vlerë, përpara asaj që mund të ndodhë... Ljuba!... Ne këmbyem kampionet e tyre dhei hodhëm në lumë. Vasilin, të vetmin dëshmitar, e nisëm pér në Moskë pér të mos u

kthyer kurrë më në Shqipëri, por, me sa duket, hesapet i kemi bërë pa hanxhinë, siç thonë shqiptarët...

LJUBA — Si?

VIKTORI — Ata kanë ndër duar edhe një kampion tjetër. Në qoftë se atyre u shkrepet në kokë ta shpien në laboratorin e Qytetit Stalin kampionin që kanë ndër duar... E sheh si janë ndërlikuar gjërat? Një incident i tillë na kushton shtrenjtë!...

LJUBA — Si është e mundur?

VIKTORI — Ja që është e mundur dhe mos harro, të gjitha rëndojnë mbi ne...

LJUBA — Unë...

VIKTORI — Nuk është fjala për të shpëtuar lëkurën tonë, Ljuba... Fjala është për diçka tjetër shumë serioze...

LJUBA — Besomëni, unë nuk jam në gjendje të kuptoj se çfarë kërkoni prej meje...

VIKTORI — Tashmë gjithçka varet nga ti...

LJUBA — Nga unë?

VIKTORI — Po. Kampioni i fundit që ata kanë është në *valixhen* e Gjergjit. Njëzet e katër orë e kam përgjuar si qen atë *valixhe*...

LJUBA — Edhe...

VIKTORI — (*Nxjerr nga çanta një kampion të rremë dhe ia zgjat Ljubës.*) Merre! Hiq nga *valixhja* kampionin e vërtetë dhe në vend të tij vendos këtë... Paskëtaj, sido që të ndodhë, ata nuk do të jenë në gjendje të kuptojnë asgjë...

LJUBA — (*Pas një heshtjeje të shkurtër.*) Kjo është e tëra?

VIKTORI — Kjo është gjithçka, Ljuba!

LJUBA — (Qesh.) Është hera e parë që ju shoh të trembur, shoku Viktor. Si është e mundur? Ju...

VIKTORI — Sikur ta dijnë se çfarë pjell ky incident «i vockël», nuk do t'ju vinte edhe aq për të qeshur, e dashur!

LJUBA — (Merr kampionin.) Atëherë qetësohuni! Kjo punë është e mbaruar. (Hap radion e hyn në kuzhinë. Pas pak kthehet së bashku me valixhen e Gjergjit dhe mbyll me çelës derën e dhomës. Fjalët e spikerit të radios shoqërojnë veprimet e saj.)

ZËRI — Ndihma e paçmuar e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ndaj Republikës PËRULLORE dhe popullit vëlla shqiptar, ka qenë dhe do të jetë kurdoherë një garanci përmiqësinë e pathyeshme ndërmjet dy vendeve tona. Bashkimi Sovjetik e ka ndihmuar dhe do ta ndihmojë pa kurrfarë interesit përpullin vëlla shqiptar në ndërtimin e socialistit. Ju flet Moska! Ju flet Moska! Dhalmë emisionin e lajmeve në gjuhën shqipe... (Ndërkohë Ljuba ka hapur valixhen, ka nxjerr prej saj kampionin e vërtetë dhe në vend të tij ka vënë kampionin fals. Shpie në dhomën tjetër valixhen është i zgjat Viktorit kampionin e vërtetë.)

LJUBA — Ja tek e keni...

VIKTORI — (Merr kampionin dhe e fut në çantën e tij.) Jeni vërtet një grua për t'u admiruar, e dashur Ljuba!

LJUBA — (*Pasi hap portën.*) Dhe tani, çfarë dëshironi? T'ju bëj një çaj apo një kakao?

VIKTORI — Nuk dua asgjë! (*Ngrihet.*) Tani duhet të kthehem pa humbur kohë në mbledhje. Ata na kanë thirrur për të sheshuar kontradiktat «teknike» me palën shqiptare...

LJUBA — E tmerrshme! Të kesh frikë nga një fëmijë i vockël të cilin me një pëllëmbë mund ta përplasësh për tokë!...?

VIKTORI — Ljuba, përderisa çdo gjë është akoma nën ujë, ne duhet të ecim sipër tij, nëpër akullin e ftohtë... Vetëm të kujdeshëm, sepse nga çasti në çast mund të rrëshqasim e mund të thyejmë kokën...

LJUBA — Prisni! Do t'ju përcjell deri poshtë tek shkallët.

VIKTORI — (*Ndalet. Pasi e vështron për një kohë të gjatë në sy i vë dorën në bel.*) Sof qenkeni bërë vërtet një grua magjepëse.

LJUBA — (*I shmanget.*) Si mashkull nuk më keni pëlqyer kurrë, shoku Viktor... Ditën e mirë!...

VIKTORI — Ditën e mirë! (*Del.*)

LJUBA — (*Afrohet ngadalë pranë tavolinës, ulet e nis të shohë njérën nga fletoret e nxënësve.*) Raskaz... Mbi... (*Por nuk lexon më tej. Përplas fletoren me nervozizëm dhe ndez një cigare. Në portë dëgjohen trokitje.*) Kush është? (*Me shpejtësi futet në aneks e vesh fustanin. Në portë dëgjohen përsëri trokitje.*) Kush është? Ja, ja, sa të vishem... (*Hap portën. Në dhomë hyn Petroja me një valixhe në dorë.*)

LJUBA — Mirëse erdhët! Urdhëroni!...

PETROJA — Gjergji nuk qenka kthyer akoma në shtëpi?

LJUBA — Jo. E kishin thirrur në një mbledhje dhe siç duket akoma nuk kanë mbaruar. Juve nuk ishit në mbledhje? (*Petroja hesht.*) Ulu-ni. Besoj nuk do të vonohet...

PETROJA — (*Afrohet pranë dritares dhe dikujt i thërret poshtë.*) Shuaje, shuaje makinën. Do të presim edhe pak. Gjergji nuk është kthyer akoma...

LJUBA — (*I jep një cigare.*) Ndizeni!

PETROJA — (*Nxjerr çibukun.*) Faleminderit!

LJUBA — Çfarë dëshironi? T'ju shtie një çaj të ngrohtë se e kam gati apo doni t'ju bëj një kafe?

PETROJA — Nuk është nevoja.

LJUBA — Mësova se punët në pus ecin mbarë...

PETROJA — (*Ftohtë.*) Të shohim...

LJUBA — Do të ishte vërtet një ëndërr e bukur.
(*Bie zilja.*) Ky është Gjergji! (*Hap portën. Gjergji hyn. Sjellja e tij e ftohtë e step.*)
Gjergji?!

GJERGJI — (*Të atit.*) U vonova ca. Selmani, ai memeci, më ndali sapo u ndamë bashkë dhe nuk më lëshonte që nuk më lëshonte. Ose të pinim së bashku një kafe ose ndryshe ishte e pamundur...

PETROJA — Është burrë i mirë, i zi...

GJERGJI — Jepte e merrte me duar. Seç desh të më thoshte. Më rrëmbeu stilografin nga xhepi dhe zhgarroviste në paketën e cigareve

një kullë nafte. Unë e shihja në sy dhe nuk kuptoja seç donte të thoshte...

PETROJA — I gjori Selman! E pra i ka pasur shokët e rrallë në naftë... Nxito, Gjergj... Shokët të presin poshtë në makinë.

LJUBA — Gjergj, përsëri do ikësh?

GJERGJI — Po... (*Largo het në dhomën tjetër. Nga jashtë.*) Baba, qindra herë jam matur të të pyes: Selmani memec ka lindur?

PETROJA — Jo, Gjergj. Njëlloj si të gjithë njerëzit. Unë e njoh atë që në vitin 1925. Punonim bashkë në Kuçovë...

GJERGJI — Pastaj?

PETROJA — Nxito, Gjergj!...

GJERGJI — Ja, ja...

PETROJA — Në 47-tën me një grup specialistësh jugosllavë që erdhën në Kuçovë atë e caktuan shoqërues. Një natë, papritur, dëgjuam se Selmanin e kishte goditur një tub në kokë dhe e kishin shpënë pa ndjenja në spitalin e Beratit. Në spital ndejeti shumë kohë. Jetën ia shpëtuan, por i gjori Selman...

LJUBA — I shkreti!... (*Hyn Gjergji.*)

PETROJA — Por e vërteta doli në shesh më vonë...

GJERGJI — E vërteta?

PETROJA — «Specialistët» jugosllavë ngulnin këmbë që zona e shtatë ishte shterpë. Një natë ata pohonin njëri me tjetrin që zona jo vetëm ishte naftëmbajtëse, po kishte pasuri të rralla... Atë çast Selmani kaloi rastësisht pranë tyre dhe i dëgjoi... Qysh prej asaj nate u hap fjala se Selmanit i ra një tub në kokë...

LJUBA — Kriminelët! Të rrëqethet mishi.

PETROJA — (*Shikon Ljubën drejt në sy.*) Vërtet të rrëqethet mishi.

GJERGJI — Kurse unë pandehja...

LJUBA — Si mund të arrijnë njerëzit deri atje?

PETROJA — Ndërsa mua nuk më duket dhe aq e pabesueshme! (*Heshtje.*) Ata e qëlluan Selmanin në kokë sepse deshën të vrisnin të vërtetën. (*Heshtje.*) Unë njoh njerëz të tjerë, njerëz që duan të qëllojnë mbi kokën e një populli të tërë! Ta bëjnë atë të verbër, të shurdhër, memec, vetëm e vetëm pér të varrosur të vërtetën... (*Heshtje. Ngrihet. Sytë i shkojnë tek peizazhet e ndryshme ruse që kanë pushtuar muret e apartamentit.*)

GJERGJI — Ku është valixhja ime?

LJUBA — (*E tronditur sjell valixhen nga dhoma tjetër dhe e vendos mbi tavolinë.*) Përsëri nuk do të kthehesh sonte në shtëpi?

GJERGJI — Të shohim...

LJUBA — Gjergj, përse sillesh në këtë mënyrë?

GJERGJI — Unë?!

PETROJA — (*Duke vështruar peizazhet në mur.*) Gjergj, sa ditë ke që nuk ke ardhur në shtëpi?

GJERGJI — Shumë... Përse?

PETROJA — Kohët e fundit, Ljuba paska bërë shumë ndryshime në apartamentin tuaj të ri... Pa shih...

LJUBA — Ju pëlqejnë?

PETROJA — (*Ironik.*) Shumë... Pasi të vish në apartamentin tuaj është vështirë të thuash që nuk ke qenë kurrë në Moskë!

LJUBA — Ironinë tuaj përdoren i gjetkë, shoku Petro, dhe jo në shtëpinë time... Ju pëlqen apo jo, juve...

GJERGJI — (*Thérret.*) Ku është valixhja ime, thashë? (*Heshtje.*)

LJUBA — Ja tek është! Përpara syve tuaj... (*Heshtje e gjatë.*)

PETROJA — (*Nxjerr nga çanta një dosje dhe ia jep Gjergjit.*) Këto shpjeri në zyrën e planit. Jepja Teftës në dorë...

GJERGJI — (*Hap valixhen dhe kërkon të shtjerë dosjen brenda. Papritur shtanget. Nxjerr kampionin ngadalë dhe shikon i trondit tur herë Petron herë Ljubën. Pastaj i drejtohet Ljubës.*) Ky kampion nuk është ai që ishte në valixhen time!

LJUBA — (*E turbulluar.*) Gjergj... çfarë ka ndodhur? Ti je zverdhur në fytyrë.

GJERGJI — Kampioni i fundit është zhdukur dhe në vend të tij...

LJUBA — Unë nuk kuptoj..

PETROJA — (*I rrëmben kampionin nga duart dhe e vështron një kohë të gjatë me vëmendje.*) Po... Ky nuk është kampioni i fundit!

GJERGJI — Baba, ti gjithmonë ke pasur të drejtë. Gjithmonë!?

PETROJA — (*I afrohet pranë.*) Qetësohu, bir. Tashmë ai kampion nuk i hyn në punë asnjjeriu. Dy javë më parë, një kampion i tillë është dërguar për analiza në laboratorin e Qytetit Stalin...

GJERGJI — (*I habitur.*) Dy javë më parë?

PETROJA — Po, Gjergj. Ai ishte veçdim il organizatës bazë të partisë... (Hesht një çast.)

GJERGJI — Kurse unë... (Hesht një çast.)

LJUBA — Gjergj, ç'është? Unë nuk ikuptoj. (Hesht një çast.)

GJERGJI — Ndërsa unë kuptoj gjithçka! (Hesht një çast.) Inxhinier Zamuhini... Kuqua... Kam-pionët... Ti... po, po, të gjitha... (Hesht një çast.)

PETROJA — Gjergj, unë po shkoj. Të pres poshtë në makinë... Kokën e ke vëtë mbi shpatullë. (Del.)

(*Gjergji dhe Ljuba ngelin të heshtur përballë njëri-tjetrit.*)

LJUBA — Gjergj!... (Hesht një çast.)

GJERGJI — Nuk dua të dëgjoj asnjë fjalë më tej...

LJUBA — (Shpërthen.) Gjergji!?!... (Hesht një çast.)

GJERGJI — (Rësërit fjalët e Ljubës.) — Hiq dorë! Gjergj! E tërë kjo histori është një aventurë e rrezikshme... Një aventurë e cilë mund të pagthet i shtrënjtë... (Hesht një çast.)

LJUBA — Gjergj!... (Hesht një çast.)

GJERGJI — Ata të gjithë po tërhiqen njëri pas tjetrit... Ata që janë përlleshur me naftën në Baku... Siberi...

LJUBA — Gjergj!... (Hesht një çast.)

GJERGJI — Unë kurre s'kam pandehur se një ditë njerëzit do të më quajnë Dulqinjë e Tobozës... (Hesht një çast.) Unë atëherë pandehja...

LJUBA — Gjergj!... (Hesht një çast.)

GJERGJI — Hesht!

LJUBA — Jo! Unë nuk mund të hesht! E tërë kjo histori është një kurth... (Hesht një çast.)

GJERGJI — Kurth?

LJUBA — Ky është një kurth për të vrarë dashurinë tonë!

GJERGJI — (Ironik.) Dashurinë? Përse nuk vazhdon më tej? Fol!... Përse nuk bie në gjunjë e të përgjërohesh duke qarë për dashurinë tonë.

LJUBA — Gjergj!...

GJERGJI — Shpjere gjer në fund rolin tënd. Tani vetëm një dëshirë më ka mbetur: dua të shoh fytyrën tënde! Fytyrën tënde të vërtetë edhe pas shfaqjes, e cila vazhdoi disa vjet me radhë...

LJUBA — (Shpërthen në të qarë dhe përplaset në kolltuk) O zot, sa fatkeqë që paskam lindur!

GJERGJI — (Pas një heshtjeje të gjatë.) Dhe tani mjaft! (Shpërthen.) Mjaft! (Ecën ngadalë në drejtim të saj.)

LJUBA — (E vështron e trembur dhe tkurret në kolltuk.) Ç'ke ndër mend të bësh?

GJERGJI — Atë që duhej të bëja me kohë! Mos u tremb! (Afrohet ngadalë dhe hap portën.) Jashtë!...

LJUBA — Si?!

GJERGJI — Por, më parë, dëgjo edhe fjalët e mia të fundit. Unë besova në fjalët e tua dhë të fala zemrën time. Të dashurova, të fala ty ndjenjat më të bukura, më të pastra, ndërsa ti... Vëç dije mirë, dhe, kudo që të jesh, kujtoi fjalët e mia: pabesia dhe dashuria nuk mund të rrojnë kurrë nën një kulm! (Heshtje.) Dhe tani... shporru!

LJUBA — (*Ngrihet ngadalë dhe i drejtohet me kërcënëm.*) Vec mos pandeh se gjithçka merr fund kaq lehtë... shoku Gjergji...

GJERGJI — Ë di...
LJUBA — Sjelljet e tua prej rrugaçit asnjeri nuk do t'i përkrahë... Në fund të fundit unë jam shtetase sovjetike dhe ti nuk ke asnjë t'i t'ë drejtë...

GJERGJI — (*Me forcë.*) Jashtë nga kjo shtëpi!

LJUBA — (*Nis mbledh plackat ndërsa Gjergji vështron i heshtur lëvizjet e saj.*) Mosmirë-njohës! Lashë Moskën, braktisa prindërit e mi, ndërsa ti! Ti përsëri do të pendohesh, por atëherë...

(*Dëgjohet pandërprerje zilja e telefonit. Të dy vështrojnë receptorin por asnjë s'e prek me dörë.*)

GJERGJI — Merre! Ndoshta të kërkon Viktori.

LJUBA — (*Me kërcënëm.*) Do të më shihni: (*Niset të dale.*)

GJERGJI — Prisni! Harruat dicë! (*Ajo ndalet. Ai sulet me rrëmbim e heq nga muret e dhomës peizazhet ruse me kornizë prej xhami dhe ia hedh tek këmbët njérin pas tjetrit.*) Merre dhe këtë... Edhe këtë... Janë tuajat! Merri dhe thuaju njerezve të tu se shqiptarët nuk bien kurrë ndër kurthe... Thuaju se shqiptarët nuk e kanë shitur dhe nuk e shesin kurrë Shqipërinë! Thuaju se shqiptarët nuk e këmbejnë kurrë idealin e Përtisë: së tyre me tradhtinë...
(*Ljuba del me nxitim, duke përplasur derën*

me forcë. Zilja e telefonit vazhdon të bjerë papushim. Gjergji e merr.) Po. Viktor, ti je? Unë dhe Ljuba kemi nevojë të ngutshme të bisedojmë me ty. Si? Po. Të presim! Në shtëpi! (Ul receptorin dhe vështron nga porta.) Përplasi derën me forcë dhe iku... «Mos-mirënlohës»... Iku dhe pas la kërcënimin e saj me një zë të çjerrë, të hollë, të gjatë si gjarpër, që vërtitet brenda këtyre mureve dhe të më frikësojnë mua... (Pa pritur i kujtohen fjalët e Petros dhe nis të shohë përsëri rreth e rrotull muret.) Pasi të vish në apartamentin tuaj është vështirë të thuash që nuk ke qenë kurrë në Moskë...

(Me rrëmbim heq njërin pas tjetrit dhe peizazhet e tjerë që janë ndër mure dhe i përplas për tokë. Copërat e xhamit shpérndahen nëpër dhomë. Me vete me zë, të lartë.) Ti gjithmonë ke pasur të drejtë, baba! Ajo donte të ndërtonte një Moskë të vogël këtu. Brenda këtyre mureve. Në fillim pushtoi muret e kësaj shtëpie, pastaj, dalngadalë, donte të pushtonte shpirtin, menj...

VIKTORI — (Hyn pa u vënë re nga Gjergji. Papritmas ndalet kur sheh tablotë e thyera të shpérndara nëpër dysheme.) Gjergj, ç'është kështu? Paska rënë tërmet këtej?

GJERGJI — Si?... Po, inxhinier Zamuhini, tërmet!

VIKTORI — Ljuba ku është?

GJERGJI — Iku!

VIKTORI — (I habitur.) Iku? Ku shkoi?

GJERGJI — Atje ku duhej tē shkonte me kohë...
VIKTORI — Gjergj, përse më thirre?

GJERGJI — Unë tē thirra? Gabohesh, inxhinier Zamuhini. Unë nuk tē thirra. Ti kishe dë-shirë tē flisje me Ljubën.

VIKTORI — Unë desha...

GJERGJI — Tē pyesnit Ljubën... Tē merrnit prej saj përgjigjen...

VIKTORI — (Përpiqet ta ndërpresë.) Inxhinier Gjergji...

GJERGJI — Për ju vëtëm një gjë ka rëndësi. Apo jo? Përgjigjja! Pra, a nuk është njëloj sikur përgjigjen t'jua jap unë në vend tē Ljubës?

VIKTORI — (Reptë.) Fjalët tuaja nuk kanë asnë kuptim... (Niset tē dalë por Gjergji e ndalon.)

GJERGJI — Prisni, inxhinier. Unë vërtet nuk iu thirra, megjithëse desha tē takohesha me ju. Po, po, mos u quditni. Njeriu nuk ka nevojë tē takojë vetëm atë që do... Në jetën e tij ka çaste kur ai do tē takojë edhe njerëz tē cilët i urren... I urren me gjithë shpirt...

VIKTORI — (Mezi përmban zemërimin.) Çfarë?

GJERGJI — Po. Dhe vrerin që ka grumbulluar thellë në shpirt t'ua derdhë në fytyrë... Në fytyrën e tyre tē vërtetë!

VIKTORI — Ju guxoni?

GJERGJI — (Vrapon. Merr kampionin dhe ia hedh ndër këmbë.) Ja përse ju thirra. Merreni!

VIKTORI — (Gjoja i habitur.) Ç'është kjo?

GJERGJI — Ajo që ju bëri tē shisnit nderin, profesionin... Idealin tuaj...

NE VEND TE EPILOGUT

(Dekori është po ai i aktit të dytë: barrantgat e punëtorëve të shpimit. Në skenë, kur hapet perdja, vëç brigadës së Petros ndodhen edhe punëtorët e tjerë që kanë ardhur për ndihmë tek zona e dytë. Të gjithë rrinë të heshtur e dëgjojnë transmetimin e ndeshjes së futbollit.)

ZERI I SPIKERIT — Kanë mbetur edhe pak sekonda që të mbarojë pjesa e parë e ndeshjes së futbollit që zhvillohet sot në stadiumin «Qemal Stafa» ndërmjet skuadrës sonë kampionës dhe «Spartakut» të Moskës. Ja, tani këto...

(Bie zilja e telefonit. Azemi ul me shpejtësi zërin e radios dhe të gjithë dëgjojnë Petron, i cili priste i shqetësuar telefonin.)

PETROJA — Alo!.. Po, zona e dytë jemi. Si? Po... Laboratorin e qytetit Stalin. Inxhinier Gjergjin, kemi kerkuar... Si? Mirë, po presim atëherë... (Le telefonin.)

AZEMI — (Hap përsëri radion.) Hajde ndeshje, hajde...

DANIA — S't'u mbyll një minutë ajo e shkretë! Zemra më thotë se sot...

ZËRI I SPIKERIT — Në pritje për t'u rilidhur më stadiumin «Qemal Stafa» po transmetojmë pjesë operistike...

AZEMI — Pushoni. Qetesi, ju lutem...
(Në barangë vëndoset qetësia. Azemi me një lëvizje teatrale merr radion nga komodina dhe e vë mbi krevatin në të cilin është shtrire Kozmai. Në dhomë shpërthejnë të qeshura. Viktori rikohet ka hyrë nga ana tjeter e skenës bashku me Aleksejn.)

VIKTORI — Shoku Petro, përse janë mbledhur këta njerëz në barangën tonë?

AZEMI — Miq, miq, inxhinier Zamuhini...
VIKTORI — (Nervoz.) Shoku Petro, nuk m'u përgjigjet. Ç'kérkojnë punëtorët e zonës së tre të në barangën tonë?

ALEKSEJ — (Ironik.) Ndoshata kanë ardhur të năndihmojnë të prishim barangat...

VIKTORI — Shoku Petro, heshtja juaj është këmbëngulje?

DANIA — Shoku Viktor, ju vërtet jeni inxhinier me eksperience, ndoshta unë jam i ri dhe...

VIKTORI — Prandaj edhe nxitohesh! Dhe mos ha-

irro, djalosh, dëshirat... jashtë mundësive e
bëjnë qesharak gjithmonë njeriun...

AZEMI — (I prekur.) Inxhinier Zamuhin, e mira e
do që të flasim pa prekur njëri tjetrin...

DANIA — Shoku Viktor, unë ju thashë... zemra ma
thotë, se në këtë mes, gjykimi juaj është i
gabuar...

VIKTORI — I gabuar?

DANIA — Përderisa të gjithë flasin kundër...

VIKTORI — Flasin kundër?

AZEMI — Po. Kundër. Ju jeni vërtet inxhinier i
zoti, shkencën e njihni njëqind herë më mi-
rë, por në fund të fundit edhe ne u rritëm
bashkë me kullat e puseve. Përderisa toka
vjen aq e fortë gjatë shpimit, mosha e saj
nuk mund të jetë kurrsesi e re...

DANIA — (Viktorit.) Atëherë si shpjegohet që ne
arritëm deri në 2800 metra dhe në shkëmb
pakësohet gradualisht materiali argjilor? Kjo
flet hapur se mosha e shkëmbit po bëhet më
e vjetër.

KOZMAI — Sipas të dhënave të kampioneve dhe
pendiciometrisë që kryen gjeofizikët, zvogli-
mi i këndit të rënies së shtresave është i va-
zdueshëm...

VIKTORI — (Ironik.) Djema!...

KOZMAI — Ju lutem! Nuk kam mbaruar. Edhe
sot copërat e shllamit tregojnë rritje të përm-
bajtjes karbonike. Pra, kjo të bën të men-
dosh se jemi afér shtresës së kërkimit... Fa-
una... unë...

VIKTORI — Përse hesht? Vazhdoni! Ne po ju dë-
gjojmë.

AZEMI — (Ngjitet në dhomë. Të gjithë e ndjekin
në heshtjet. Ai sjell prerjen e trungut të pus-
sit të vitzuar. Ia drejtën Viktorit.) Po kjo?

Në prerjen faktikisht të pusit, shillami del
ndryshe! Edhe këtë poshtë ta hedhim, inxhi-
nier?

VIKTORI — Më falni! Kësaj i thonë... Ju doni të
hidhni shkencën tej, të imbyllim sytë, të
mbyllim veshët dhe të lëmë së na tèrhëqin
hundën dëshirat drejt marrëzisë? Jo! Kjo
nuk do të ndodhë kurri! Si vështë e mün-
dur?... Kemi një vit të téréqë po robtohem,
përleshemi me të fshehtat e tokës, miliona
lekë, buka e popullit, djersa, gjaku i tij jänë
hedhur në erë, dhe ju mendoni që kjo aven-
turë të vazhdohet më tej? Kurri!

PETROJA — Shoku Viktor, siç duket këta njerëz
nuk i njihni mirë...

VIKTORI — Inxhiniér Berti, përsë heshtni? Juve
nuk jum lejohet të heshtni! Ju duhet...

PETROJA (Shpërthen.) Të ma mbushni mendjen
me argumente shkençore, që zona është
shterpë?... Ndërsa ju heshtni, inxhiniér Berti!

VIKTORI — Si t'i marr këto fjalë, iusta Petro?

PETROJA — Ashtu si i dëgjuat...

VIKTORI — Çfarë?

PETROJA — Shpimin do ta vazhdojmë më tej...

VIKTORI — Çështë kjo gjuhë, shoku Petro?

PETROJA — Shqip! Ne shqiptarët vëtëm një gjuhë

kemi, shoku Viktor!

VIKTORI — Kohët e fundit këtë gjuhë, ju e keni

shpërdorur...

PETROJA — Por veshët që e kanë dëgjuat nuk te

Nuk e kanë kuptuar! Nuk e kanë kuptuar jo se janë
sinqatë shurdhën por sepse populli ynë ka një
fjalë të urtë, inxhinier: «Shurdi më i madh
më botë është ai që nuk do të dëgjojë...»

VIKTORI — Vetëm respekti që kam përmoshën
tuaj më ndalon t'ju quaj...

AZEMI — (Hidhet i fyri.) Inxhinier!

PETROJA — (Me qëtësi.) Mos e ndërprisni... (Hesh-
tje gjatë.)

VIKTORI — Në fund të fundit këtu përgjegjës jam
unë. Përpara qeverisë llogarë jap unë dhe
askush tjetër...

PETROJA — Gabohesh, inxhinier Zamuhini! Përg-
jegjës nuk je ti!

VIKTORI — Kush?

PETROJA — Partia!

VIKTORI — Dhe ju flisni...

PETROJA — Po... Në emër të organizatës bazë të
partisë. (Heshtje.) Edhe organizata bazë e
partisë edhe drejtoria e kombinatit, mendoj-
në që shpimi të vazhdojë më tej...

VIKTORI — (I skandalizuar.) Edhe tani? Edhe tani
kur të gjitha shpresat janë të humbura?

AZEMI — (Shpërthen.) Viktor!...

PETROJA — (I përgjigjet Viktorit me qëllim që të
ndërpresë Azemin.) Po. Edhe tani. (Heshtje
e gjatë.)

ALEKSEJ — Shoku Petro, në fund të fundit shpi-
mi nuk mund të vazhdojë më tej pa kolonë
teknikë...

AZEMI — Atëherë çfarë duhet të bëjmë sipas jush?

ALEKSEJ — Të presim...

AZEMI — Të presim?!

ALEKSEJ — Të presim ndërsa kolona tekneke të
vijës nga Bashkimë Sovjetik.

AZEMI — Deri kur duhet të presim, Aleksej? Deri
kur? Sipas kontratës, kolona duhej të kishte
ardhur tre muaj më parë nga Bashkimë
Sovjetik. Dhë sa duhet të presim akoma?

ALEKSEJ — Në jemi specialistë dhe nuk përgji-
gjemi për kontratat. Unë...

VIKTORI — (Aleksejt.) Nuk është nevoja, Aljosha.
(Heshtje e shkurtër.) Unë edhe shokët e mi
jemi të detyruar të largohemi. Të heqim
dorë njëherë e përgjithmonë nga kjo aven-
turë...

PETROJA — Nxitoheni, inxhinier?

VIKTORI — Përkundrazi. Durimi ynë kaloi çdo
kufi.

PETROJA — Ju përsëriti, inxhinier Zamuhini, ven-
dimi për largimin tuaj nuk është vetëm i
nxituar. Ai...

VIKTORI — (E ndërtret.) Është shumë i saktë, sho-
ku sekretar i organizatës bazë të partisë.
Derisa ju nuk përfillni rezultatet negative
kohët e fundit; derisa nuk përfillni arsy-
timet tonë teknike...

PETROJA — (Shpërthen.) Inxhinier Zamuhini, as-
njëra nga këto nuk fsheh dot arsyen e vë-
tetë të largimit tuaj...

VIKTORI — Çfarë?

PETROJA — Asnjëra! Ikja juaj i ka rrënjet gjetiu...

VIKTORI — (Me shpatulla në mur.) Me ju nuk pra-
nøj të bisedoj më tej! Veç ju kujtoj se do të

protestoj në drejtori, në komitetin e partisë, në ministri, në Komitetin Qendror.

PETROJA — (Qetë.) Të jeni i bindur se asnjeri s'do t'ju pengojë...

VIKTORI — (I nxehur.) Aleksej! Përgatisni plaçkat pér qytet! (*Niset të dale por ndalon papritur.*) Rruga juaj të shpie vetëm në një vend: në humnerë. Ne nuk ju ndjekim dot në atë rrugë...

PETROJA — Inxhinier Zamuhini, ne jemi mësuar që të vegjël të ecim vetëm, bile në netë të errëta, nëpër pyje plot me ujqër...

(*Viktori dhe pas tij Aleksej largohen nga skena. Të gjithë shohin në drejtim të tyre.*)

AZEMI — (Vetes.) Rruga juaj të shpie në humnerë. Ne nuk ju ndjekim pas në atë rrugë... (*Pas një heshtjeje të shkurtër, shpërthen.*) Pabesi, Usta Petro!... Kjo është... pabesi!...

PETROJA — Ata pandehin se do t'u biem ndër gjunjë, t'u puthim dorën e t'i lutim të mos ikim. T'u lutemi të mos na lënë vetëm... (*Shpërthen.*) Gabohesh, inxhinier Zamuhini. Ne nuk jemi mësuar të ecim në jetë me paterica. Shqipëria i ka flakur patericat tej, qysh në dyzet e katrën dhe ka ecur gjithmonë mbi këmbët e veta... (*Zilja e telefonit. Merr receptorin Azemi.*)

AZEMI — Alo? Kush? Komiteti i Partisë? Usta Petron...

PETROJA — (Flet në telefon.) Unë jam. Po, po... Pastaj na kërcënuan se do të heqin dorë një-

herë e përgjithmonë nga kjo aventurë... Si?...
Ju presim... Mirë se të vini!

(Që jashtë skene dëgjohen thirrjet e gëzuara
të Gjergjit.)

GJERGJI — Djalë! Djalë! Usta Petro, Dane...
(Ai hedh nga gëzimi në ajër përgjigjen e la-
boratorit dhe kudo shpërthen entuziazmi.
Përqafime, urime, të qeshura.)

PETROJA — Gjergji!

GJERGJI — Baba!

PETROJA — Ti po qan?

GJERGJI — Janë lot gëzimi, baba...

DANIA — Usta Petro...

PETROA — Djema, Petroja ju pyet juve...

AZEMI — Atëherë dëgjoje fjalën tonë, usta Petro...
Me thonj do të gërmojmë dheun dhe naftën
do ta nxjerrim nga strofka e saj...

DANIA — Mua ma ndiente zemra. Zemra gjithmonë
më thoshte se ne nuk do të shkulemi nga kjo
barangë pa e prekur naftën me duart tona...

KOZMAI — Usta Petro, atdheu, Partia, kërkojnë
naftë nga ne... Edhe ne, sikur jetën tonë të
japim, naftën do t'ia rrëmbejmë tokës...

GJERGJI — Po, vëlla, do t'ia rrëmbejmë... Dhe ata,
Zamuhini dhe ustallarët e tij, le ta marrin
vesh njëherë e përgjithmonë se ne do ta
nxjerrim naftën vetë, me duart tona... vetë!
(Në skenë dalin nga dera e dhomës së tyre,
me valixhe në dorë, Viktori dhe Aleksej. As-
një nuk lëviz. Të gjithë vështrojnë në drej-
tim të tyre.)

VIKTORI - Të shohim si do të bëni vetëm tanë e tutje! Vetëm... Pa, nè! (Dalin.)

PETROJA - Shihni. Ikën. Në kthyen shpinët dhe ikën... Kështu ka ikur dhe kështu do të iki kurdoherë tradhtia nga ky truall... E kërrusur dhe me shpinë, ajo do të eci, nëpër rrugica tjetër, errëta të historisë, pér të fshehur fytyrën e saj të vërtetë...

Ndërsa ne, me Partinë tonë, do të xecim kurdoherë ballë lart në rrugën e drejtë dhe plot drithë të revolucionit!

FUND

...ndiqat shkaktoj se është vërtetë që kurdoherët janë shumë më të shpejtë se që vjen. Duket se që shpejtësi është një gjë që mund të ndodhet edhe në këtë rast.

...ndiqat shkaktoj se është vërtetë që kurdoherët janë shumë më të shpejtë se që vjen. Duket se që shpejtësi është një gjë që mund të ndodhet edhe në këtë rast.

...ndiqat shkaktoj se është vërtetë që kurdoherët janë shumë më të shpejtë se që vjen. Duket se që shpejtësi është një gjë që mund të ndodhet edhe në këtë rast.

...ndiqat shkaktoj se është vërtetë që kurdoherët janë shumë më të shpejtë se që vjen. Duket se që shpejtësi është një gjë që mund të ndodhet edhe në këtë rast.

...ndiqat shkaktoj se është vërtetë që kurdoherët janë shumë më të shpejtë se që vjen. Duket se që shpejtësi është një gjë që mund të ndodhet edhe në këtë rast.

...ndiqat shkaktoj se është vërtetë që kurdoherët janë shumë më të shpejtë se që vjen. Duket se që shpejtësi është një gjë që mund të ndodhet edhe në këtë rast.

Bungo, L.

Pabesia. Dramë (Red, I. Thoma)

T., «Naim Frashëri», 1980.
80. f:

(B. m.) dhe

(B. v.): 891.983-2

B 93

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1980